



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

STRATEGJIA KOMBËTARE E ENERGJISË
2013 -2020

Tiranë, Prill 2012

PASQYRA E LËNDËS

NR.	PËRMBAJTJA
	Hyrje
1	SITUATA AKTUALE E SEKTORIT TË ENERGISË DHE SFIDAT
1.1	Strategjia e Vitit 2003 dhe Strategjia e Përditësuar
1.2	Furnizimi me Burime Primare Energjetike
1.3	Energjia Elektrike
1.3.1.	Furnizimi me energji elektrike
1.3.2.	Humbjet
1.3.3.	Importi
1.4.	Hidrokarburet
1.4.1.	Furnizimi me naftë dhe nënprodukte të saj
1.4.2.	Furnizimi me Gaz Natyror dhe Gaz të Lëngshëm të Naftës
1.5.	Energjitë e rinovueshme
1.6.	<u>Politikat fiskale dhe ato tarifore</u>
1.6.1.	Tarifat e energjisë elektrike
1.6.2.	Politikat fiskale dhe çmimet e naftës dhe nënprodukteve të saj
1.7.	Rezervat
1.7.1.	Hidroenergja
1.7.2.	Hidrokarburet
1.7.3.	Qymyri
1.7.4.	Energjitë e rinovueshme.
1.8.	Organizimi i sektorit
1.8.1.	Institucionet
1.8.2.	Organizimi i sektorit publik të energjisë elektrike
1.8.3.	Organizimi i sektorit hidrokarbur
1.9.	Situata e sektorit energjetik në rajon
2	VIZIONI, PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE
3	POLITIKAT
3.1.	Skenarët
3.1.1.	Zhvillimi i sektorit energjetik sipas skenarit të Eficencës së Energjisë
3.1.2.	Zhvillimi i sektorit energjetik sipas skenarit të Eficencës së Energjisë dhe të Burimeve të Rinovueshme
3.2.	Ristrukturimi institucional i Sektorit Energjetik Shqiptar
3.2.1.	Organizimi i institucioneve
3.2.2.	Organizimi i sistemit elektroenergjetik
3.2.3.	Organizimi i shoqërive publike në sektorin e hidrokarbureve
3.3.	Kuadri ligjor dhe rregullator
3.3.1.	Legjislacioni i sektorit elektro-energjetik
3.3.2.	Legjislacioni i sektorit të hidrokarbureve
3.3.3.	Ligji për energjitë e rinovueshme
3.3.4.	Ligji për eficientë e energjisë dhe hartimi i kuadrit nënligjor të tij
3.4	Energjia elektrike
3.4.1.	Optimizimi i Sistemit të Furnizimit dhe Rritja e Sigurisë së Furnizimit me Burime Energjetike

3.4.2.	Masterplani i zgjerimit të Rrjetit të Transmetimit për energjinë elektrike për periudhën deri në 2020
3.4.3.	Masterplani i rehabilitimit të sistemit të Shpërndarjes për periudhën deri në 2020
3.4.4.	Humbjet teknike
3.5.	Ecuria e Tarifave të Energjisë Elektrike deri në vitin 2020
3.6.	Hidrokarburet
3.6.1.	Infrastruktura e importit dhe stokimit të hidrokarbureve
3.6.2.	Prodhimi i naftës dhe i gazit deri në vitin 2020
3.6.3.	Lidhja e Shqipërisë me Rrjetet Ndërkombëtare të Naftës dhe Gazit
3.7.	Nxitja e Përdorimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë
3.8.	Nxitja e Përdorimit Efiçent të Energjisë
3.9.	Hapja e Tregut të Energjisë
3.9.1.	Hapja e tregut të energjisë elektrike
3.9.2.	Tregu i naftës, gazit dhe produkteve të tyre
3.10.	Privatizimi
3.10.1.	Privatizimi i sektorit të energjisë elektrike
3.10.2.	Privatizimi i sektorit të hidrokarbureve
4.	FINANCIMET E PROJEKTEVE
5.	LLOGARIDHËNIA
6.	PLANI AFATSHKURTËR I MASAVE PËR REALIZIMIN E “STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERGJISË”, TË PËRDITËSUAR, PËR PERIUDHËN 2012-2015
7.	LITERATURA

GRAFIKËT DHE TABELAT

GRAFIKËT

Grafiku. 1: Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori

Grafiku. 2: Konsumi final i energjisë elektrike sipas çdo sektori

Grafiku. 3: Konsumi final i produkteve të naftës sipas sektorëve

Grafiku.4. Totali i Burimeve Primare Energjetike (2005-2010)

Grafiku. 5: Humbjet në sistemin elektroenergjetik

Grafiku. 6: Ecuria e prodhimit vendas të naftës bruto sipas vendburimeve dhe e konsumit

Figure 7: Konsumi final i energjisë dhe kërkesa finale e energjisë për Shqipërinë deri në vitin 2030

bazuar në skenarin referues. Figura 8: Ecuria e Kërkesës totale finale e energjisë pa dhe me efikasitet energjie bazuar në PKVEE & RE

Figure 9. Ecuria e Targeteve të Efikasitetit të Energjisë në % sipas PKVEE dhe PKVBR

Figura 10 Ecuria e kërkesës për Gaz Naturor deri në vitin 2030

Grafiku. 11: Tarifat e energjisë elektrike sipas strategjisë të vitit 2003

Grafiku. 12: Tarifat e energjisë elektrike në strategjinë 2013-2020

Figura 13 Kostua totale e sistemit energjetik sipas skenarëve

Figura 14 Shpenzimet sipas sektorëve

TABELA

Tabela 1 Treguesit kryesorë të energjisë elektrike

Tabela 2 Treguesit kryesorë të skenarit të referencës

Tabela 3 Ecuria e kursimeve sipas Planit të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë

Tabela 4. Investimet e parashikuara për energjitë e rinovueshme

Tabela 5: Raporti i investimeve

SHKURTIME

METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKE	Agjencia Kombëtare Energjisë
ANE	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
ARMO	Albanian Refining and Marketing of Oil
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for Economic Co-operation and Development)
OPEC	Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (Organization of Petroleum Exporting Countries)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
IQT	Inspektorati Qëndror Teknik
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
EURO (€)	Monedha Europiane
f (b)	Fuçi (1 fuçi amerikane = 0,14 ton metrik)
GDP	Gross Domestic Production (Prodhimi i Brëndshëm Bruto)
PBB	Prodhimi i Brëndshëm Bruto (Gross Domestic Production)
GLN	Gaz i Lëngët i Naftës
GN (NG)	Gaz Natyror (1 m ³ gaz natyror = 1 kg naftë brut = 10000kkal = 41 860 kJ (kiloxhaul))
GNL (LNG)	Gaz Natyror i Lëngëzuar.(1m ³ G.N.L. = 600m ³ gaz natyror)
FK	Fuqia Kalorifike
KE	Komisioni Europian
kal	Kalori
Kkal	Kilokalori
kW	Kilovat
kWh	Kilovat-orë
ktoe	mijë ton naftë ekuivalent
l	Litër
Mt	Milionë ton
Mtoe	Milionë ton naftë ekuivalent
MW	Megavat
MWh	Megavat-orë
TW	Teravat
TWh	Teravat-orë.
Nm ³	Normal metër kub (njësi matje vëllimi gazi natyror)
ppm	Pjesë për milionë. Përdoret kryesisht për të përcaktuar sasinë e metaleve ose papastërtive të tjera në produktet e rafinuara të naftës.
Bcm	Bilionë (miliardë) metra kub (m ³)
CO	Monoksid karboni
CO ₂	Dioksid karboni (Gaz karbonik)
SO ₂	Dioksid sqfuri
US\$	Dollar Amerikan

HYRJE

Strategjia Kombëtare e Energjisë shpreh në thelb përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të sektorit energjetik, si një sektor mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë.

Rritja e sigurisë së furnizimit, krjimi i një ekonomie kompetitive dhe respektimi i normave mjedisore, janë qëllimet bazë të kësaj strategjie.

“Strategjia Kombëtare e Energjisë” për periudhën 2013 -2020 përbën një detyrim të Qeverisë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 424, datë 26.06.2003 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë deri në vitin 2015”, si dhe të angazhimeve që Shqipëria ka marrë në kuadër të integritit të saj në Bashkimin Europian.

Shqipëria, nisur nga mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të instaluara si për prodhimin ashtu dhe për transmetimin e energjisë elektrike, është përballur me vështirësi në furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve. Gjatë viteve të fundit, në periudhën 2005-2012, janë realizuar projekte dhe investime të konsiderueshme në sektorin energjetik, duke sjellë përmirësime të ndjeshme në këtë sektor. Përmirësime të ndjeshme ka patur në zhvillimin e infrastrukturës së import-eksportit të energjisë, sikurse janë linjat e interkoneksionit, terminalët e nënprodukteve të naftës, qendra dispeçer dhe nënstacionet e tensionit të lartë. Rritje të ndjeshme ka patur edhe prodhimi i naftës brut, në kuadër të implementimit të marrëveshjeve hidrokarbure, duke e rritur me rreth tre herë prodhimin e naftës krahasuar me vitin 2000.

Mungesa e burimeve primare të energjisë, mungesa e burimeve dhe rrjeteve të gazit, kapacitete të limituara të prodhimit dhe të interkoneksionit, si dhe varësi e plotë e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, janë disa nga vështirësitë, që kanë patur impaktin e tyre në mënyrë direkte dhe indirekte në jetën ekonomike dhe në cilësinë e kushteve të jetesës të vendit tonë.

Për këto arsye, kjo strategji, pasi analizon situatën aktuale të sektorit energjetik në tërësi, parashtron politikat energjetike, që duhet të ndjekë qeveria në këtë sektor, ku përmendim: përmirësimin dhe harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me direktivat e Bashkimi Europian, ristrukturimin institucional, diversifikimin e burimeve duke promovuar burimet e rinovueshme dhe rritjen e efikasitetit të energjisë, vendosjen e tarifave reale për energjinë elektrike. Njëkohësisht, kjo strategji përcakton investimet dhe kohën e zbatimit të tyre për të realizuar këto politika.

Strategjia fokusohet në një nga çështjet kryesore të vlerësimit të situatës aktuale dhe perspektivës së zhvillimit të sektorit energjetik në Shqipëri, atë të kontributit dhe përfitimeve direkte të ekonomisë Shqiptare dhe Buxhetit të Shtetit nga aktiviteti i sektorit energjetik në Shqipëri. Ajo merr në konsideratë faktin, që gjithmonë e më tepër aktiviteti privat po bëhet dominant në këtë sektor, si në prodhim-gjenerim, në transport-transmetim, ashtu dhe shpërndarje. Në këtë kontekst kanë mjaft rëndësi politikat fiskale dhe ato tarifore, që zbatohen dhe duhet të zbatohen në këtë sektor, të cilat në esencë shprehin politikat dhe strategjinë e Qeverisë dhe të Shtetit Shqiptar, për ndërtimin e një sektori energjetik eficient, fizibël, kompetitiv, të sigurt dhe të integruar.

Në këtë kontekst, ky dokument përfshin të gjithë hapsirën e zhvillimit të sektorit energjetik si dhe detyrimet e vendit tonë në realizimin e targeteve të vendosura nga Komuniteti i Energjisë, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e kërkesës për energji, si dhe mbulimin e saj deri në vitin 2020. Mbulimi i kërkesës bazohet në kapacitetet ekzistuese prodhuese, rezervat energjetike, opsionet e transmetimit dhe të furnizimit, nevojat për kapacitete të reja, përdorimin e energjive të rinovueshme, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe deri tek sjellja e konsumatorëve.

Skenarët e zhvillimit të Strategjisë do të ekzaminojnë politika të rëndësishme energjetike, që do të përballen me vendime të politikbërësve duke përfshirë:

- Opsionet, që kërkojnë sigurinë e furnizimit, për të arritur ritjen e kërkesës për energji në terma afat-gjatë,
- Mënyrën e rritjes së sigurisë, për furnizimin me energji elektrike, në një sistem me një dominim të prodhimit të saj nga hidrocentralet;
- Mundësitë dhe opsionet financiare, për të arritur targetet e Komunitetit të Energjisë dhe të Bashkimit European, për eficientë e energjisë, përdorimin e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme dhe reduktimin e emëtimeve të CO₂.

Sfidat e kësaj Strategjie do të jenë orientimi i drejtë i zhvillimeve të sektorit energjetik, në përputhje të detyrimeve, që ka vendi ynë, në zbatim të nismës 20/20/20 të Bashkimit European, i shoqëruar me politika, programe dhe me veprime aktive të të gjithë aktorëve, në çdo degë të ekonomisë, për të zbatuar të gjitha hapat e parashikuara me investimet dhe në afatet e caktuara, në mënyrë, që sektori energjetik, të sigurojë një furnizim të garantuar dhe me kosto të ulët të konsumatorëve me burime energjetike.

1. SITUATA AKTUALE E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE SFIDAT


Të dhëna statistikore

Nga një vështrim i përgjithshëm i furnizimit gjithsej me burime energjetike primare, nga viti 1990 e deri në ditët e sotme, vërejmë se furnizimi për të gjithë sektorët ka pësuar një rritje nga viti në vit. Përrjashtim në këtë ecuri ka patur periudha 1990 -1992, në të cilën rënia e furnizimit me energji arriti nga 2.26 Mtoe në vitin 1990, në 1.22 Mtoe në 1992, si pasojë e mbylljes së aktiviteteve të shumë konsumatorëve industriale.

Më pas, situata e furnizimit me burime primare energjetike ka ardhur duke u përmirësuar për të arritur në vlerën 2105.55 Ktoe për vitin 2010.

Lidhur me konsumin final të burimeve energjetike, në grafikun 1 vërejmë se konsumi, sipas sektorëve të ekonomisë, nga viti 1999 deri në vitin 2010 ka pësuar ndryshime jo të mëdha. Konsumi final i burimeve në vitin 2010 ka qenë në vlerën 1879.36 ktoe. Në vitin 2010 kemi një rritje të konsumit total të energjisë me 1%, krahasuar me vitin 2009, si pasojë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë si dhe e rritjes vjetore të fluksit të automjeteve.

Spektori i transportit mban peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 40.43 %, sektori i banesave 26.06 %, industria 16.32 %, sektori i shërbimeve 8.51 % dhe bujqësia e të tjerat 8.68 %.



Grafiku. 1: Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori [ktoe] (Burimi: AKBN)

Konsumi final i energjisë elektrike sipas sektorëve të ekonomisë është paraqitur në grafikun 2. Në vitin 2010 sektori i banesave ka konsumuar 45.7 % të energjisë elektrike. Pas tij vjen sektori i industrisë me 18.3 %, më pas sektori i shërbimeve me 21.3 %, dhe në fund vjen sektori i bujqësisë me 1.8 %. Vlen të theksojmë, se pas vitit 2008 KESH-i, nëpërmjet një harmonizimi të kënaqshëm të importeve gjithvjetore të energjisë elektrike, si dhe me përpunimin racional të rezervës hidroenergjetike në kaskadë, arriti të kryejë furnizimin e plotë të konsumatorëve të vendit tonë me energji elektrike.


Vlen të përmëndim, se në periudhën 2007-2011, nga analiza në mënyrë të detajuar e të dhënave të prodhimit të energjisë elektrike, vërehen ndryshime jashtëzakonisht të mëdha.

Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstremale arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të vendit tonë, të mbështetur vetëm në HEC-e.

Po kështu, për periudhën 2007-2011 vërehet një rritje e ndjeshme e prodhimit vendas të naftës brut, duke arritur në vitin 2011 në 891 000 ton (nga rreth 320 000 ton, që ka qënë në vitin 2000), ndërkohë që përpunimi i naftës brut në rafineritë e vendit ka pësuar rënie, si në vlerë absolute, por për më tepër në vlerë relative, në krahasim me prodhimin e naftës brut në vend, duke bërë, që të rritet gjithmonë e më tepër eksporti i naftës brut.

Në grafikun 3, paraqitet konsumi final i produkteve të naftës, ndarë sipas sektorëve të ekonomisë, për periudhën 1999-2010, ku vërejmë një rritje të konsumit të naftës në sektorët e transportit, të shërbimeve dhe të industrisë.

Produktet e naftës e kanë rritur kontributin e tyre në konsumin final të energjisë nga 57.2% në vitin 1999 në 59.53 % në vitin 2010. Rritja e kontributit të tyre ka ndodhur për shkak të uljes së konsumit të druve të zjarrit, qymyrit dhe gazit natyror nga njëra anë, por edhe për shkak të rritjes së konsumit të nënprodukteve të naftës nga sektori i transportit nga ana tjetër.



Bazuar në bilancin energjetik të vitit 2010, rezulton, që sektori i transportit ka konsumuar rreth 67.9 % të produkteve të naftës, sektori i industrisë 14.1 %, sektori i bujqësisë përfshirë dhe peshkimin ka konsumuar 7.4 %, shërbimet 3.1 % dhe sektori i banesave ka konsumuar 7.4 % të produkteve të naftës.

1.1 Strategjia e Vitit 2003

Gjatë periudhës nga viti 2003 deri në vitin 2011, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, janë shënuar një numur shumë i madh arritjesh në këtë sektor, që kanë të bëjnë me:

- hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të sektorit energjetik

- ristrukturimin e shoqërive tregtare me kapital 100% shtetëror dhe ndarjen e tyre në shoqëri sipas veprimtarive;
- privatizimin e disa shoqërive të rëndësishme të këtij sektori
- përmirësimin dhe fuqizimin e infrastrukturës prodhuese dhe transmetuese në këtë sektor
- shtimin e investimeve dhe pjesëmarrjen e operatorëve privat në këtë sektor;

Megjithatë, sikurse dihej, që në vitin 2003, në kohën e hartimit dhe miratimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, jo gjithçka në sektorin energjetik do të zgjidhej për të arritur standartet e shërbimit, që sigurohen në vendet e Bashkimit Europian.


Më poshtë janë renditur problemet kryesore, që nuk janë zgjidhur deri tani, me të cilat përballlet ende sektori energjetik dhe që duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave përkatëse për këtë sektor.

- Vazhdon të ruhet e njëjta strukturë e furnizimit me burime primare energjetike. Diversifikimi është në nivel të pamjaftueshëm. Kontributet i takojnë burimeve të tilla si të naftës, hidroenergjisë dhe të druve të zjarrit, ndërsa kontributi i qymyrit, gazit natyror, apo i burimeve të tjera alternative janë në nivele minimale;
- Kapaciteti ekzistues gjenerues është i pamjaftueshëm për të përballuar kërkesën për energji elektrike;
- Humbjet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike vazhdojnë të jenë të larta. Për vitin 2011 ato ishin në nivelin rreth 35.6 %;
- Humbjet jo teknike të energjisë elektrike në shpërndarje vazhdojnë të jenë në nivele të larta;
- Konsumi shumë i lartë i energjisë elektrike për qëllime ngrohjeje;
- Mosliberalizimi i çmimit të energjisë elektrike vazhdon të ketë ndikim në përdorimin joeficient të saj;
- Moslidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit natyror;
- Rritja dhe modernizimi i kapaciteteve përpunuese të naftës brut në vend, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit dhe përmirësimin e bilancit ekonomik të vendit;
- Eficiencë e ulët në përdorimin e burimeve energjetike në degë të ndryshme të ekonomisë, si dhe mungesa e një standardi bashkëkohor lidhur me menaxhimin e energjisë;
- Nevoja për plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues mbi eficientë, nevoja për implementimin e detyrueshëm të ligjeve ekzistuese
- Nevoja për plotësimin e kuadrit ligjor për energjinë si dhe implementimi i tyre
- Rishikimi i regjimit të mbajtjes së rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me produkte energjetike hidrokarbure;
- Përdorimi i GLN-së nuk është bërë në ritmet e parashikuara. Për vitin 2010 konsumi i GLN-së arriti në 110 Ktoe;
- Përdorimi në nivele tepër të ulta i sistemeve të paneleve diellore, për sigurimin e ujit të ngrohtë në sektorët e banesave dhe shërbimeve.

1.2. Furnizimi me Burime Primare Energjetike

Furnizimi me burime primare energjetike për vendin tonë, për vitin 2010, ka qenë në vlerat e 2105.55 ktoe. Në furnizimin sipas burimeve, për vitin 2010, vlen të përmendet, që hidrokarburet kanë kontribuar me 1232.9 ktoe, ose 58.71 % përkundrejt totalit, energjia elektrike me 584.31 ktoe, ose 27.82 %, drutë e zjarrit me 213 ktoe, ose 9.76 %, dhe pjesa tjetër përbëhet nga burime të tilla si qymyri, gazi natyror dhe energjia e përfuar nga panelet diellore.

Pavarësisht se furnizimi me produkte primare energjetike vjen gjithmonë në rritje, tregu i vendit tonë kërkon përmirësime në sigurinë e furnizimit me energji.



Grafiku:4. Totali i Burimeve Primare Energetike (2005-2010) [ktoe]
(Burimi: AKBN)

1.3. Energjia Elektrike

1.3.1. Furnizimi me energji elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë është i bazuar në prodhimin e saj nga burimet hidrike (më shumë se 98%), prandaj dhe besueshmëria e sistemit tonë elektroenergetik është shumë e varur nga kushtet hidrike. Fuqia e instaluar e Sistemit Elektroenergetik Shqiptar është rreth 1531 MW dhe prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e vendit, duke qënë se është nga burimet hidrike, ka natyrë propabilitare, që lëviz nga rreth 3 miliard kWh/vit deri në 7,7 miliard kWh/vit, në varësi të kushteve hidrike (rreth 7,7 miliarde kWh në vitin 2010). Prodhimi mesatar vjetor është rreth 4.2 miliard kWh. Duke patur në konsideratë, që kërkesa për energji elektrike në vendin tonë aktualisht është 7.342 TWh/vit, dhe prodhimi vendas rreth 4.2 TWh/vit, pra është i pamjaftueshëm, bën të detyrueshëm që aktualisht, mbulimi i nevojave duhet të përballohet nëpërmjet importit të energjisë elektrike.

Nga ana tjetër, duhet të vëmë në dukje, që kapacitetet importuese të vendit tonë janë të limituara. Kjo vjen si pasojë e kapaciteteve të limituara, që kanë linjat tona të interkonjeksionit me vendet fqinjë, por edhe të linjave të interkonjeksionit të vendeve të rajonit, pasi vendi ynë është pikë fundore në rrjetin rajonal të energjisë elektrike.

Duhet theksuar gjithashtu, se importi i energjisë elektrike është vështirësuar edhe për shkak të rritjes së defiçitit të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit, ku numri më i madh i vendeve, përveç Bullgarisë, Rumanisë dhe Bosnje Hercegovinës, janë importues neto të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2011 prodhimi i përgjithshëm neto i energjisë elektrike nga shoqëritë publike të gjenerimit ka qënë 4 021 245 Milion kWh, kurse prodhimi total, që merr parasysh edhe prodhimin nga sektori privat i gjenerimit prej 136 831 Milion kWh, arriti në 4 158 831 Milion kWh (4.158 TWh)

Viti 2011, nga pikpamja hidrologjike, vlerësohet si një vit me prurje me shkallë të ulët sigurie, gjë që ka ndikuar jo pozitivisht në prodhimin e energjisë elektrike në vend, duke shënuar një nga vitet me prodhimin më të ulët në historikun e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Në tabelën 1 janë paraqitur treguesit kryesorë të energjisë elektrike nga viti 2002 dhe deri në vitin 2011.

Tabela 1 Treguesit kryesorë të energjisë elektrike


Emertimi	Viti									
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770	5201	7743	4185
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1884	0	3262
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,750	6,300	6592	6773	6872
Sasia vjetore e Ujit (Miljard,m3)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12	6.00	10.85	5.08
Konsumi specifik (m3/kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.40	1.04	1.19	1.20	1.20

Rritja mesatare vjetore e kërkesës për energji, në vleftë absolute, gjatë kësaj periudhe rezulton me 183 GWh/Vit. Në periudhën përpara vitit 2008, për shkak të ndërprerjeve të programuara, të detyruara, të energjisë ky tregues nuk është real. Duke ju referuar viteve 2009, 2010 dhe 2011, konstatojmë, se rritja e kërkesës për energji në vitin 2010 rezulton 378 GWh më shumë në vleftë absolute se në vitin 2009, ose me 6% më shumë, ndërsa në vitin 2011 me 372 GWh ose me 5% më shumë se viti 2010.

1.3.2. Humbjet

Një nga problemet më të rëndësishme, i cili në mënyrë kronike ndikon në uljen e efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike, në rritjen e pamotivuar të kërkesës për energji elektrike, si dhe në rritjen e çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike, mbetet problemi i humbjeve të energjisë elektrike, të cilat prej vitesh janë shumë më të mëdha, se ato që evidentohen në sistemet normale elektroenergetike të vendeve të zhvilluara.

Më poshtë jepet ecuria e konsumit total të energjisë elektrike dhe e nivelit të humbjeve nga viti 2002 deri në vitin 2011:



Grafiku. 5: Humbjet në sistemin elektroenergetik (GWh) (Burimi: KESH)

Humbjet e energjisë elektrike, përfshirë ato teknike dhe jo teknike, përfaqësojnë sfidën më të vështirë dhe me efektin më të rëndë dëmtues në veprimtarinë ekonomiko-financiare të OSSH- së (ÇEZ Shpërndarje sh.a). Ato dëshmojnë njëkohësisht edhe për punën e madhe, që ende duhet të bëhet, në mënyrë që ky problem të gjejë zgjidhjen e duhur.

Konsumi i energjisë elektrike, sidomos në nivelet e tensionit të ulët, shoqërohet me humbje shumë të mëdha teknike në rrjetin e shpërndarjes, për shkak të mbingarkesës dhe të rrjetit të amortizuar. Sasia e energjisë elektrike, që merret para matësit apo që nuk faturohet, të ashtuquajturat humbje joteknike, vlerësohet të jetë në një nivel të lartë, krahasuar me konsumin faktik.

Për vitin 2011 humbjet e përgjithshme teknike dhe jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, rezultojnë në një vleftë prej 2440 GWh ose me 35.6 %, të energjisë, që hyn në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa së bashku me humbjet në transmetim rezultojnë në 2440 GWh ose në 35 % të energjisë gjithësej që hyn në rrjet.

1.4. Hidrokarburet

1.4.1. Furnizimi me naftë dhe nënproduktet e saj

Furnizimi i ekonomisë me nënprodukte naftë dhe gazi realizohet nga importi dhe prodhimi vendas. Megjithëse prodhimi vendas i nënprodukteve të naftës dhe gazit plotëson rreth 12.5 % të nevojave të ekonomisë, kjo për shkak të mospërpunimit të gjithë sasisë së naftës bruto të prodhuar në vend. Produktet e naftës të përpunuara në vend luajnë rol në tregun e vendit për konsumatorët industrial dhe të shërbimeve. (Grafiku 6). Niveli i prodhimit të naftës bruto në total (Albpetrol, Bankers Petroleum Albania Ltd dhe Stream Oil & Gas) për vitin 2011 arriti në 894.530 Ktoe i cili është niveli më i lartë në 15 vitet e fundit.

Duhet theksuar se, për një shfrytëzim më të mirë të vendburimeve tona të naftës, për rritjen e koeficientit të naftënxyerjes nëpërmjet përdorimit të teknologjive të ndryshme si dhe për kërkimin dhe zbulimin e vendburimeve të reja, janë nënshkruar dhe miratuar marrëveshje hidrokarbure me disa kompani të huaja të tilla si Bankers Petroleum Albania Ltd, Steam Oil & Gas, Sharewood International Ltd dhe IEC Visoka Inc. në vendburimet ekzistuese dhe Island International Exploration BV, Medoil dhe DWM Petroleum AG si dhe Petromanas Albania GmbH, Island International Ltd; Capricorn, Bankers Petroleum Albania Ltd. në blloqet e reja të kërkimit.


Sektori i rafinimit të naftës bruto përballet me vështirësi, si pasojë e teknologjisë së vjetër, si dhe mungesës së një sistemi modern për operacionet e punës dhe mirëmbajtjes së sistemit të kontrollit. Ai ka pasur probleme serioze në kontrollin e ndotjeve mjedisore, të cilat dora dorës, për shkak të investimeve të realizuar në këtë sektor, ka pësuar përmirësime. Pas privatizimit të ARMO Sh.A të 85% të aksioneve, ka përpjekje serioze në drejtim të cilësisë të prodhimit të nënprodukteve, duke përmendur këtu Gazoilin, ndërkohë, që duhet të vazhdohet në drejtim të rritjes së cilësisë së nënprodukteve të tjera, për të qënë konkurruese në tregun vendas dhe atë rajonal, por edhe për të mundësuar rritjen e kapaciteteve përpunuese të naftës bruto në vend, duke realizuar kështu një rritje të vlerës së këtij burimi natyror strategjik me të cilën është e pasur nëntoka Shqiptare.

Sektori i rafinerisë është i privatizuar dhe përfaqësohet nga shoqëria ARMO sh.a ku shteti ka 15 % të aksioneve. Në zhvillimet strategjike të sektorit të energjisë opsioni për ndërtimin e një rafinerie të re është marrë në konsideratë.

Infrastruktura bregdetare e import-eksportit dhe depozitimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve është modernizuar dhe operohet në dy terminale bregdetare, atë të (Porti Vlorë-1)Vlorës dhe të Porto-Romanos, Durrës, (Porti "Porto Romano"), të cilat kanë kapacitete të konsiderueshme përpunimi dhe depozitimi, si dhe janë ndërtuar në përputhje me standartet e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Shpërndarja gjeografike e impianteve, magazinave dhe stacioneve të shitjes të shoqërive të tregtimit me shumicë dhe shoqërive të tregtimit me pakicë, përfshin të gjithë territorin e Shqipërisë. Ato garantojnë një furnizim normal të konsumatorëve në mbarë vendin. Rezerva e sigurisë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Për vitin 2007, ajo ka qënë 41 684 ton dhe për vitin 2008 ka qënë në nivelin e 102 985 ton dhe në vitin 2010 ajo është 187 886 ton Megjithatë, në kuptimin e menaxhimit të rezervës së sigurisë ka nevojë për një rishikim, kjo në përputhje edhe me rekomandimet e Sekretariatit

të Komunitetit të Energjisë, dhe për këtë qëllim gjatë vitit 2012, është parashikuar të bëhet një studim i thelluar për rezervën e sigurisë.



Grafiku. 6: Ecuria e prodhimit vendas të naftës bruto sipas vendburimeve dhe e konsumit [ktoe]
Burimi: AKBN

1.4.2. Furnizimi me Gaz Natyror dhe Gaz të Lëngshëm të Naftës

Aktualisht, vendi ynë ka një prodhim minimal gazi natyror, rreth 4-5 Milion Nm³, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për furnizimin e rafinerive dhe proceseve teknologjike të industrisë së naftës. Pavarësisht, angazhimet dhe nxitjen e investitorëve të huaj, nga të gjitha strukturat e shteti shqiptar, vendi ynë nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Është e kuptueshme, se lidhja e Shqipërisë me rrjetin e gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive, ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon nënprodukteve të naftës dhe energjisë elektrike.

Gazi i lëngët i naftës (GLN) në vendin tonë, ka rritur në mënyrë të ndjeshme prezencën dhe po luan një rol gjithmonë e më të madh në tregun vendas, si burimi energjetik alternativ më i mundshëm, për të zëvendësuar energjinë elektrike në sektorin e banesave dhe shërbimeve, duke u konsumuar kryesisht për ngrohje dhe gatim, duke arritur në total për vitin 2010 një konsum prej 110 ktoe. Një përdorim gjithmonë e më të gjerë kjo lëndë energjetike po gjen në industrinë ushqimore dhe atë të ndërtimit.

Duke patur parasysh GLN-në si alternative energjetike, që zëvendëson me shpejtësi konsumin e energjisë elektrike, politika e Qeverisë është drejtuar në zhvillimin e kapaciteteve depozituese në volume të ritura, për të ulur koston e transporthit. Në mbështetje dhe në zbatim të këtyre objektivave strategjike, si rezultat i investimeve të realizuara gjatë viti 2009, u futën në shfrytëzim terminalët bregdetarë të naftës në Gjirin e Vlorës (Porti Vlora-1 dhe terminali i depozitave nga shoqëria koncesionare “La Petrolifera Italo Albaneze”sh.a.), si dhe në zonën e Porto-Romanos, Durrës, (Porti “Porto Romano” nga shoqëria koncesionare “Romano Port”sh.a.

1.5. Energjitë e rinovueshme

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, për të implementuar në politikat energjetike kombëtare të saj, kërkesat e Direktivave të Bashkimit Europian, përsa i takon rregullave për krijimin

dhe zhvillimin e tregut të brëndshëm të energjisë dhe promovimin e prodhimit dhe konsumit të energjisë nga burimet e rinovueshme të saj.

Direktiva për promovimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme është transpozuar në Ligjin e ri "Për burimet e rinovueshme", si dhe në Ligjin e aprovuar për Biokarburantet. Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore janë duke punuar për të përgatitur aktet nënligjore respektive.

Pas analizimit të mekanizmave nxitës të mundshme dhe rishikimit të praktikave më të mira të kryera nga shtetet e tjera, anëtare të BE-se, në vendin tonë, që nga 19 Janari 2007, është adoptuar një sistem për tarifën fëd-in në mënyrë të veçantë, për HEC-et e vegjël, ekzistues dhe të rinj, i cili ofron një siguri më të madhe për investitorët dhe siç ka treguar eksperienca ka filluar të japë rezultatet e veta.

Sistemi i tarifave fëd-in krijon kushte për promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme. Duke theksuar se niveli i këtyre tarifave ka marrë parasysh tipin, teknologjinë, si dhe efikasitetin e paisjeve gjeneruese të energjisë.

Ligji për burimet e rinovueshme dhe Ligji për Biokarburantet, gjithashtu, ofrojnë incentiva të tjera si:

- përparësi për lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes;
- pagesën vetëm të kostove direkte të lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- marrëveshje shitblerjeje afatgjata (15 vjet për energjinë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 15 MW)
- blerjen e detyrueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e vegjël.

Ligji i Biokarburanteve, gjithashtu, ka të përfshira incentiva për përdorimin e biokarburanteve në sektorin e transportit si më poshtë:

- përzierja e detyrueshme e biokarburanteve me naftën dhe derivatet e saj;
- reduktimi i normës së akcizës, për shkak të përzierjes së karburantit në një përqindje të caktuar;
- normë zero për akcizën e karburanteve që janë bio.

Si rezultat i këtyre masave, interesi për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme është rritur në mënyrë të ndjeshme dhe kanë filluar të ndërtohen, para së gjithash, hidrocentrale të rinj, si teknologji më e njohur dhe më e besueshme, e ndjekur nga sistemet e paneleve diellore për ujë të ngrohtë dhe për vendosjen e turbinave të prodhimit të energjisë nga era. Në një shkallë më të ulët, kanë filluar të kërkojnë autorizime nga investitorët, për ndërtimin e paneleve diellore, për prodhimin e energjisë elektrike.

Në vitin 2011, në Zonën Energjetike dhe Industriale të Porto Romanos u vu në shfrytëzim impianti i prodhimit dhe bledingut të biokarburanteve, që është njëkohësisht edhe impianti i parë i këtij lloji në Shqipëri.

Nisur nga pozicioni gjeografik, me një klimë tipike mesdhetare, Shqipëria zotëron burime të konsiderueshme të energjive të rinovueshme. Këto burime mund të shfrytëzohen jo vetëm për zvogëlimin e kontributit të energjisë elektrike nga burimet konvencionale, por dhe për përfitimin e energjive të tjera të pastra.

Hidroenergja është përfitimi më i madh nga burimet e rinovueshme në vendin tonë. Shqipëria renditet në Europë si një vend me pasuri ujore të konsiderueshme, me një shtrirje hidrografike të shpërndarë, pothuaj në të gjithë territorin.

Shqipëria, me sipërfaqen e saj prej 28 748 km², ka një shpërndarje hidrografike me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej rreth 44,000 km² ose 57% më shumë se territori shtetëror. Nga pikpamja topografike, duke qenë një vend me relief relativisht të thyer, vendi ynë ka një rezervë hidroenergjetike të madhe.

Nëpërmjet një politike konkensionare konkurruese e transparente dhe të mbështetur në një kuader të plotë ligjor dhe nënligjor, u bë e mundur që të nënshkruhen dhe miratohen nga Qeveria, 112 kontrata konkensionare, për ndertimin e HEC-eve me fuqi të vogël, të mesme dhe të madhe, me investitorë vendas dhe të huaj, prej të cilëve pritet, që të futet në shfrytëzim një potencial gjenerues hidroelektrik prej rreth 1400 MW, që parashikohet të prodhojë një sasi energjie elektrike nga burime të rinovueshme prej 4 miliardë kWh në vit.

Territori i Shqipërisë është i vendosur në pjesën perëndimore të Ballkanit dhe ka një potencial të lartë për shfrytëzimin e **energjisë diellore**. Numëri i ditëve me diell në vendin tonë luhet nga 240 – 260 ditë me një maksimum prej 280 ditë, megjithatë kontributi i kësaj energjie, përkundrejt totalit të burimeve energjetike, është jo më shumë se 0.1%. Kryesisht energjia diellore shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe një pjesë fare e vogël e kësaj energjie shfrytëzohet me panele fotovoltaike. Bazuar në të dhënat e vitit 2010, penetrimi i paneleve për ujë të ngrohtë është 23.5 m²/1000 banor

Për këtë arsye, në strategjinë kombëtare të energjisë, shtimi i përdorimit të paneleve diellore është prioritet i qeverisë dhe në këtë kuadër po punohet me një projekt në bashkëpunim me UNDP.

Shfrytëzimi i **energjisë së erës** në vendin tonë akoma nuk ka filluar, por ka një shprehje shumë të madhe interesimi nga investitorë të huaj, për shfrytëzimin e këtij burimi. Në këtë kuadër, janë në studim disa rajone të vendit tonë nga disa kompani të huaja. Deri në fund të vitit 2011, nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës si dhe nga ERE janë licensuar 15 kompani, për të ndërtuar parqe eolike me një fuqi të instaluar prej rreth 1 600 MW, të cilat shtrihen kryesisht në zonën bregdetare të vendit, duke filluar nga qarku i Lezhës në veri e deri në rajonin e Sarandës në jug.

Biomasa në vendin tonë vlerësohet si burim energjie dhe është ngushtësisht e lidhur me drutë e zjarrit. Në vitin 2010, rezulton që 93% e druve të zjarrit të përdorura, janë konsumuar për ngrohje dhe gatim dhe vetëm 7% është përdorur në shërbime të tjera. Biomasa kontribuon nëpërmjet druve të zjarrit në bilancin energjetik të vendit me 7.76 %. Në mbështetje të shrytëzimit të biomasës në vitin 2008 është dhënë licenca për ndërtim, instalim dhe prodhim të energjisë elektrike, nga një TEC-i me fuqi të instaluar 140 MW

Energjia gjeotermale është vlerësuar deri tani në kuadër studimor.

1.6. Politikat fiskale dhe Tarifat

1.6.1. Tarifat e energjisë elektrike

Çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike përfaqësojnë një çështje me ndjeshmëri të lartë për të gjithë opinionin publik, mbasi ato prekin financiarisht, sikurse në të gjitha vendet e botës, të gjitha kategoritë shoqërore të një vendi.

Reforma e tarifave të energjisë elektrike ka filluar që në vitin 1994, për t'ju përshtatur kushteve të reja të zhvillimit ekonomik të vendit.

Pas vitit 1994, është bërë një rritje graduale e çmimit mesatar të shitjes me pakicë të energjisë elektrike. Duke mbajtur në konsideratë, se konsumatorët e energjisë elektrike, të lidhur në nivele të ndryshme tensioni, karakterizohen nga nivele të ndryshme shpenzimesh, në metodologjinë e caktimit të çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike, u pa e domosdoshme të zbatohet parimi i ndarjes së pagesave për shërbimet e gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, edhe sipas nivelit të tensioneve.

Në kuadër të kalimit të KESH-it, nga një korporatë vertikalisht e integruar, në disa kompani juridikisht, financiarisht dhe organizativisht të ndara, në kushtet e përshtatjes të tregut tonë me tregun rajonal të energjisë dhe në zbatim të direktivës 2003/54 të Bashkimit Europian, rezultoi e nevojshme, që rritjet e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të bëhen në mbështetje të parimit të mbulimit të kostove reale të shërbimit për çdo grup konsumatorësh dhe në nivele të ndryshme tensioni, që do të thotë, që për nivele të ndryshme tensioni (shërbimi) do të ketë nivele të ndryshme çmimesh dhe tarifash.

Kjo praktikë çoi në ndarjen reale të kostove ndërmjet operatorëve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, sipas kategorive të ndryshme të konsumatorëve dhe njëkohësisht edhe në zvogëlimin e subvencioneve të kryqëzuara.

1.6.1. Parimi i përcaktimit të çmimit të energjisë elektrike me dy blloqe

Nisur nga niveli i të ardhurave të pamjaftueshme të konsumatorëve familjarë nga njëra anë dhe e nevojës për rritjen e çmimit mesatar të shitjes së energjisë elektrike nga ana tjetër, duke filluar nga data 1 Mars 2008, në Shqipëri është implementuar skema me dy blloqe konsumi, me tarifa të ndryshme për çdo bllok.

Blloqet janë ndarë duke patur parasysh plotësimin e nevojave më të domosdoshme të një familjeje (konsumatori shtëpiak) për energji elektrike dhe mundësinë e përfitimit nga burimet hidrike disponibël në Shqipëri.

Është pranuar të quhet energji elektrike e nevojës së parë, ajo sasi energjie, e cila përdoret nga konsumatorët familjarë, për të plotësuar ato nevoja të veprimtarisë jetësore, të cilat nuk mund të mbulohen nga burime të tjera energjie.

Nevojat për gatim dhe veçanërisht për ngrohje të banesës, duke qenë se në treg ekzistojnë mundësitë që ato të plotësohen edhe me burime të tjera energjetike, me të njëjtin efektivitet dhe komfort sikurse me energji elektrike, nuk janë konsideruar të nevojës së parë.

Në këtë rast është me rëndësi, që të përcaktohet sasia e energjisë elektrike si nevojë e parë, e dallueshme nga pjesa tjetër e konsumit të energjisë. Koncepti i energjisë elektrike të nevojës së parë çon kështu në vlerësimin e dy tarifave për konsumatorët familjarë, në tarifën e energjisë elektrike si nevojë e parë dhe në tarifën e energjisë elektrike për komfort. Një tarifim i tillë njihet me emrin tarifa të energjisë elektrike me dy blloqe për konsumatorët familjarë.

Sasia mesatare mujore e energjisë elektrike të nevojës së parë, për çdo familje, vlerësohet në rreth 277 kWh. Disa vende të rajonit mund të kenë nivele më të ulta të bllokut të kësaj energjie, por duhet të mbahet në vëmendje, se vendet e tjera zotërojnë burime gazi me kosto të ulët, me të cilat mund të plotësojnë një pjesë të mirë të nevojave të tyre energjetike.

Blloku i parë, me një konsum prej 300 kWh në muaj, për vitin 2011 paguhet me një çmim prej 7,7 lekë për kWh, kurse konsumi mbi këtë bllok paguhet me 13.5 lekë për kWh.

Aplikimi i çmimeve të diferencuara për blloqet shërben edhe si një instrument, që nëpërmjet mekanizmit të çmimit, të nxitet përdorimi i gazit të lëngët dhe lëndëve të tjera energjetike alternative për gatim, ngrohje banese, etj. Gjithashtu, një parim i tillë do të nxisë përdorimin me efikasitet të energjisë elektrike nga familjarët.

Në këtë kuadër konsiderohet e rëndësishme, që të aplikohen lehtësira fiskale dhe incentiva të tjera, të cilat do të ndikojnë në nxitjen e përdorimit të lëndëve alternative energjetike, si zëvendësuese të energjisë elektrike.

Aplikimi i tarifës incentivuese (féd in tariff) si një mekanizëm për promovimin e gjenerimit të energjisë elektrike nga HEC-et e vegjël është një experience, që duhet të aplikohet edhe për burimet e tjera të rinovueshme.

1.6.2. Politikat fiskale dhe çmimet e naftës dhe nënprodukteve të saj.

Politikat fiskale dhe çmimet e naftës dhe nënprodukteve të saj trajtohen nga një kuadër ligjor i kompletuar dhe përfshijnë si elementët e sistemit fiskal në sektorin e prodhimit, ku më kryesori është taksa e rentës minerare (royalty tax), ashtu dhe sistemi fiskal, i përcaktuar sipas ligjit nr. 7811/1994 i cili përcakton një shkallë të tatimit prej 50%, të aplikuar në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure.

Përsa i përket taksave të tjera, për produktet hidrokarbure nuk ka taksë doganore, ndërkohë, që ka taksë doganore për importin e naftës brut. Për tregtimin e nënprodukteve të naftës paguhet taksa e akcizës, por edhe taksat e tjera, që përcakton legjislacioni shqiptar në fuqi, sikurse është taksa e karbonit, etj.

Tarifat për sektorin e gazit përcaktohen sipas ligjit “Për sektorin e gazit natyror” dhe institucioni përgjegjës është Enti Rregullator i Energjisë.

Politika e çmimeve të lëndëve djegëse me bazë hidrokarbure ka qenë thelbësore për investime sidomos në tregtimin e nënprodukteve të naftës dhe të lëndëve të tjera energjetike. Në periudhën 2006 – 2008, liberalizimi i çmimeve të hidrokarbureve, krahas çmimeve në tregun e nënprodukteve të naftës dhe të gazit, u shtri në mënyrë graduale edhe në tregtimin e naftës brut, duke patur në konsideratë, që pas procesit të privatizimit të ARMO sh.a., çmimi i tregëtimit të naftës brut të prodhuar në vendburimet ekzistuese nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. dhe shoqëritë e huaja që operojnë mbi bazën e Marrëveshjeve Hidrokarbure, aktualisht është totalisht i lidhur me çmimin e kuotur në bursën ndërkombëtare të naftës bruto. Për këtë, janë bërë edhe ndryshimet e nevojshme, në kuadrin ligjor në fuqi, sikurse është ndryshimi në ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993, “ Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, të ndryshuar nëpërmjet ligjit nr. 10298, datë 08.07.2010, “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, si dhe është miratuar Urdhëri i Ministrisë, nr. 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”.

Politika e çmimeve të lëndëve djegëse me bazë hidrokarbure është e lidhur ngushtësisht me politikat fiskale, pasi pothuajse për të gjitha nënproduktet e naftës, aplikohet taksa e akcizës, si dhe taksa për karbonin, me përjashtim të gazit të lëngëzuar të naftës. Për naftën brut dhe nënproduktet e saj nuk ka taksë doganore, me përjashtim të importit të naftës brut, mbi të cilën aplikohet taksa doganore.

1.7 Rezervat

1.7.1. Hidroenergja

Shqipëria renditet në Europë si një vend me pasuri ujore të konsiderueshme në raport me popullsinë, me një shtrirje hidrografike të shpërndarë pothuajse në të gjithë territorin e saj. Edhe pse rreth 98% e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet, deri tani është shfrytëzuar vetëm 35 % e potencialit hidroenergjetik të vendit. Kapaciteti hidroenergjetik ekzistues i instaluar është rreth 1433 MW. Rezervat totale të hidroenergjisë mundësojnë instalimin e një fuqie prej rreth 4500 MW dhe potenciali vjetor i prodhimit mund të arrijë në rreth 16-18 TWh.

1.7.2. Hidrokarburet

Rezervat gjeologjike të vendburimeve të vendit tonë vlerësohen rreth 437 Milion ton naftë. Në varësi të natyrës së rezervuarit natyror të vendburimeve të naftës rezulton se, në vendburimet ranore janë depozituar 77,7% të rezervave totale gjeologjike. Deri tani janë nxjerrë rreth 50 milion ton dhe ndodhen ende në nëntokë edhe rreth 386 milion ton naftë (rezerva gjeologjike).

Rezervat e gazit në vendburimet e njohura të gazit natyror e të naftës të vendit tonë llogariten të jenë 3 miliardë e 630 milion m³N. Ato i përkasin vendburimeve të gazit natyror dhe vendburimeve të naftës e gazokondensatit në trajtën e gazit të tretur në naftë apo të kondensuar dhe të gazit të lirë në kapelet gazore të disa vendburimeve.

1.7.3. Qymyri

Qymyret e vendit tonë kanë fuqi kalorifike që varion nga 2000 kkal/kg në 3000 kkal/kg dhe nxirren nga një thellësi që shkon deri në 300m, me trashësi shtrese 0.7-1m. Rezervat e parashikuara të qymyrit janë 794 milionë ton. Ato përqëndrohen kryesisht në zonën e Tiranës, me rreth 86% të rezervave, në zonën e Korçë-Pogradecit me 10% dhe në zonën e Memaliajt me 4%.

Përdorimi i qymyrit të vendit në të ardhmen e afërt nuk është parashikuar, për arsye të kostos së lartë të përfuturit të tij dhe karakteristikave fiziko-kimike jo të favorshme. Sidoqoftë, nisur nga rezervat e limituara të hidrokarbureve në botë, opsioni i përdorimit të qymyrit të importit, për nevojat energjetike është lënë i hapur. Natyrisht, që përdorimi i tij do të bëhet duke respektuar rregulla të forta mjedisore të impianteve, që do të përdorin këtë lëndë energjetike.

1.7.4. Energjitë e rinovueshme

Shqipëria ka potenciale të konsiderueshme të burime të rinovueshme.

Energjia nga burimet hidrike. Në fushën e HEC-ve të vegjël është duke u punuar me intensitet për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve hidrike (HEC-et e vegjël dhe të mesëm), por gjithashtu dhe për rritjen e mundshme të kapaciteteve të atyre ekzistuese.

Aktualisht, janë paraqitur shumë projekt-propozime të pakërkuara për ndërtim hidrocentralesh të vegjël me koncesion. Janë miratuar 112 kontrata koncesionare për HEC, me fuqi të instaluar totale prej rreth 1740 MW.

Energjia Diellore në vendin tonë shfrytëzohet kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe fare pak për prodhim energjie elektrike. Ajo shfrytëzohet kryesisht në shtëpitë e vecuara si dhe në hotele, pranë zonave bregdetare. Potenciali teorik për shfrytëzimin e energjisë diellore shkon nga 1200 kWh/m² në pjesën verilindore deri në mbi 1600 kWh/m² në zonën e Myzeqesë. Nga një vlerësim i ditëve me diell rezulton, se Shqipëria ka një mesatare të orëve me diell në të gjithë vendin me rreth 2400 orë/vit. Kurse, në zonën e Fierit, janë regjistruar dhe rreth 2815 orë/vit me diell.

Energjia e Erës është duke u studjuar në Shqipëri nga kompani të ndryshme, të cilat kanë marrë autorizime për studimin e zonave të ndryshme të vendit tonë. Nga vlerësimet paraprake konstatohet, se erëra me shpejtësi mbi 5 m/s për lartësinë 10 m, rezultojnë të jenë rreth 2200 orë, kurse për lartësitë nga 50 deri 75 m orë në vit, me shpejtësi mbi 5 m, rezultojnë të jenë rreth 3000 orë. Është konstatuar, se vendet më të përshtatshme për ndërtimin e parqeve me erë, për prodhimin e energjisë

elektrike janë zona bregdetare, duke filluar nga Lezha deri në Butrint, Gryka e Vjosës, Masivi malor Qëndror dhe zona e Devollit.

Deri në tremujorin e parë të vitit 2012, nga ERE dhe nga METE, janë licensuar 15 kompani të ndryshme për të ndërtuar parqe eolike, që shfrytëzojnë energjinë e erës, me një fuqi të instaluar prej rreth 1600 MW. Ato shtrihen kryesisht në zonën bregdetare të vendit, duke filluar nga qarku i Lezhës në veri e deri në rajonin e Sarandës.

Energjia e biomasës përftohet si energji e pastër nga përpunimi i nënprodukteve të drurit ose të agrikulturës, nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Në Shqipëri biomasë, si lëndë energjetike përdoret në formën e saj tradicionale për ngrohje dhe gatim, nëpërmjet druve të zjarrit apo mbetjeve të tjera të agrikulturës. Sipas vlerësimeve paraprake të përafërta, energjia e biomasës në vendin tonë është rreth 7 Mtoe, kurse energjia e biomasës e siguruar nga mbetjet bujqësore është llogaritur në rreth 130 toe/vit.

Energjia gjeotermale. Sipas studimeve në Shqipëri ekzistojnë disa zona në të cilat ka mundësi shfrytëzimi i energjive gjeotermale. Në qendrën e Ultësirës Perëndimore, dendësia e fluksit të nxehtësisë është 41.3 mW/m² në Masivin Malor, duke filluar nga jugu deri në verilindje të vendit, dendësia e fluksit të nxehtësisë luhetet nga 40 mW/m² deri në 61.8 mW/m².

Mundësia për prodhimin e energjisë elektrike, në disa vendburime ka afërsisht këto kapacitete: Llixhat e Elbasanit kanë fuqi të mundshme për tu instaluar në rreth 2700 kW. Pusi gjeotermal Kozani-8 ka fuqi të mundshme për tu instaluar rreth 2000 kW. Burimet termale të Peshkopisë vlerësohen me rreth 1600 kW, pusi Ishmi-1/b me rreth 644 kW, etj.

Aktualisht, në Shqipëri, energjia gjeotermale përdoret vetëm për qëllime kurative.

1.8. Organizimi i sektorit

1.8.1. Institucionet

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është autoriteti më i lartë shtetëror në hartimin e politikave dhe strategjive në sektorin e energjisë. Misioni i METE-s në sektorin e energjisë është të zhvillojë politika, për të siguruar një furnizim normal të konsumatorëve me burime energjetike, për të garantuar rritjen ekonomike të vendit. Ajo përcakton politikat në nivel kombëtar, për rritjen e kontributeve të burimeve energjetike, përfshirë burimet e rinovueshme të energjisë, politikat në fushën e eficiencës së energjisë dhe të bëjë të mundur aksesin, për realizimin e masave të veprimit, për zbatimin e këtyre politikave.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) u krijua zyrtarisht në Maj 1996 në përputhje me ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike". Anëtarët e Bordit të Komisionerëve të tij emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Ai funksionon si një institucion i pavarur nga strukturat ekzekutive të shtetit dhe ka për detyrë rregullimin e sektorit energjetik, përfshirë dhënien, ndryshimin dhe revokimin e licensave, përcaktimin e tarifave, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të energjisë elektrike, përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive të pjesëmarrësve të tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese, që sigurojnë aksesin e palëve të treta. Në vitin 2008, ky ent u shndërua nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike në Entin Rregullator të Energjisë dhe kryen detyrat e mësipërme edhe për sektorin e gazit.

Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është krijuar me VKM Nr. 547, datë 09.08.2006, si rezultat i bashkimit të ish Agjensisë Kombëtare të Hidrokarbureve dhe Institutit të Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve. Me VKM Nr.202 datë 11.04.2007, ish-AKE-ja shkrihet si institucion dhe bëhet pjesë e AKBN-së.

AKBN-ja është institucion në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit përgjegjës për energjinë. Institucioni shërben si organ i specializuar për hartimin e strategjisë së energjisë, ndjek zbatimin e saj, planifikon nevojat për energji, harton bilancin energjetik, promovon burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë.

Zbaton politikat e qeverisë në fushën e mineraleve, hidrokarbureve dhe hidroenergjetikës.

Sherbimi Gjeologjik Shqiptar ushtron aktivitetin e tij në fushën e gjeoshkencave në bazë të ligjit Nr. 8366, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datën 02.07.1988, i cili e njeh atë si këshilltar teknik e shkencor i shtetit në fushën e gjeoshkencave.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ushtron veprimtarinë e tij. Puna e tij ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e vendit. Kështu, studimi dhe monitorimi i ujrave nëntokësorë ndikon në menaxhimin e rezervave ujore, duke siguruar një furnizim me ujë të popullatës dhe ekonomisë e duke parashikuar të gjitha masat për ruajtjen e kolektorëve ujëmbajtës nga dëmtimi dhe ndotja. Një bashkëpunim korrekt i qeverisjes qendrore dhe asaj lokale me këtë institucion është thelbësor në zgjidhjen e kërkesës për ujë.

Inspektoriati Qëndror Teknik (IQT) është krijuar me Ligjin Nr.9295, datë 27.7.2006, si bashkim i Inspektoriatit Shtetëror të Kontrollit të Naftës dhe të Gazit, Inspektoriatit të Enëve nën Presion dhe Inspektoriatit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike. Ky Inspektoriat ka për detyrë të ushtrojë kontroll tek të gjitha subjektet publike ose private lidhur me zbatimin e kërkesave, normave dhe standarteve të vendosura për nënproduktet e naftës, enët nën presion dhe instalimet elektrike.

Qendra për Eficiencën e Energjisë Shqipëri-BE (QË) si një strukturë jo qeveritare e krijuar në Qershor të vitit 1996, mbi bazën e një marrëveshje midis Qeverisë Shqiptare dhe BE-së. Roli i saj është realizimi i disa projekteve të eficiencës së energjisë dhe promovimin e saj.

1.8.2. Organizimi i sektorit publik të energjisë elektrike

Më poshtë jepet organizimi i shoqërive anonime publike, që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) është përgjegjëse për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e asetëve të gjenerimit (Kaskada e Lumit Drin me 1350 MW, Kaskada e Lumit Mat me 50 MW, Kaskada e Bistricës me 27,5 MW, HEC Lanabregas me 5 MW, Fier TEC 159 MW (jashtë funksionit) dhe TECI i Ri i Vlorës 97 MW. KESH-i është i paisur edhe me licencën e Furnizuesit Publik me Shumicë të energjisë elektrike për klientin tariforë dhe mund të luajë dhe rolin e furnizuesit të fundit për konsumatorët e kualifikuar.

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST sha) është përgjegjës për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit 400-220 dhe 110 kV, përfshirë dhe nënstacionet e këtyre tensioneve. Luan dhe rolin e operatorit të tregut.

Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sha) është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes 110-35-20-10-6 dhe 0.4 kV, përfshirë nënstacione dhe pikat e transformimit në këto nivele tensioni. Ai është i paisur edhe me licencën e Furnizuesit Publik me Pakicë, kryesisht me furnizimin, faturimin dhe arkëtimin e faturave të konsumatorëve tariforë;

Qe nga viti 2009, 76% të aksioneve të kësaj shoqërie zotërohen nga kompania private ÇEZ dhe njihet si shoqëria ÇEZ Shpërndarje sh.a.

Aktualisht, në dy kompanitë e para, shteti, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotëron 100% të kapitaleve, kurse në shoqërinë ÇEZ Shpërndarje sh.a. shteti zotëron 24% te aksioneve.

1.8.3. Organizimi i sektorit hidrokarbur

Drejtimi i administrativ dhe organizativ i sektorit hidrokarbur bëhet nga METE, nëpërmjet disa Drejtorive të Përgjithshme, si

- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore (DPRR), në përbërje të së cilës funksionon Sektori Rregullator dhe i Menaxhimit të Projekteve dhe Kontratave Hidrokarbure, si pjesë e Drejtorisë së Standardeve Elektroenergjetike,
- Drejtoria e Përgjithshme e Ofrimit të Shërbimeve (DPOSH), në përbërje të së cilës është Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, si dhe Drejtoria e Privatizimit,

të cilat sipas objektit të punës së tyre, synojnë të realizojnë një furnizim të rregullt të konsumatorëve me burime energjetike hidrokarbure, në përputhje edhe me rolin rregullator të shtetit në këtë sektor.

Në fushën e transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, mbizotërojnë shoqëritë private të tregtimit, duke mbuluar 100% të nevojave të tregut. Në të gjithë territorin e vendit tonë, numëri total i stacioneve të shitjes me pakicë është rreth 870, të shpërndara në territorin e vendit, ndërsa stacionet e shitjes së GLN janë 110.

Pjesë e infrastrukturës së transportit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre janë edhe dy terminallet bregdetare të import/eksportit të këtyre produkteve në zonën e Gjirit të Vlorës dhe në Zonën e Porto Romanos, Durrës.

Në aktivitetin e kërkim-zbulimit të vendburimeve të reja mbizotërojnë shoqëritë e huaja, të cilat operojnë mbi bazën e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me shtetin shqiptar.

Në shoqëritë publike, që funksionojnë aktualisht në vendin tonë në sektorin e hidrokarbureve, shteti vazhdon të luajë rol minimal në aktivitetet e tyre, vetëm në atë të prodhimit të naftës dhe gazit natyror, ndërkohë, që nga ana tjetër, sa vjen dhe rritet roli monitorues dhe mbikqyrës i strukturave të Qeverisë, duke mundësuar kështu një shfrytëzim sa më eficient të naftës bruto, të këtij burimi natyror jo të ripërtëritshëm, me rëndësi startegjike për Shqipërinë

Në sektorin publik të naftës dhe gazit operojnë: shoqëria Albpetrol sh.a. përgjegjëse për aktivitetin e kërkimit, prodhimit, shërbimeve, etj. e cila tashmë vepron kryesisht mbi bazën e marrëveshjeve hidrokarbure me shoqëri të huaja për prodhimin e hidrokarbureve dhe zhvillimin e vendburimeve egzistuese, e cila është në procesin e privatizimit dhe në përputhje me programin e qeverisë, pritet të privatizohet brënda 2012 në 100% të aksioneve. Është miratuar ligji nr.10490, datë 15.12.2011 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a. Patos". Petrol Alba sh.a. Tiranë, që kryen aktivitetet të shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve. Shoqëria ARMO sh.a., në të cilën 85% të aksioneve të saj janë privatizuar, është përgjegjëse për rafineritë (Ballsh, Fier) si edhe në aktivitetet e saj të shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve (bazuar në burimet e brëndshme).

1.9 Situata e sektorit energjetik në rajon

Përmirësimi i performancës të sektorit energjetik është thelbësor, për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit tonë, por ajo duhet parë dhe në kontekst të situatës energjetike në vendet e Europës Juglindore. Situata e furnizimit me energji elektrike është vështirësuar shumë nga viti 2006, pas mbylljes së centraleve bërthamore në Bullgari, rritjes së kërkesës për energji elektrike dhe krijimit të nyjeve të ngushta të transmetimit në rajonin tonë.

Rajoni i Europës Juglindore ballafaqohet me një risk të madh lidhur me mundësinë e plotësimit të rritjes së kërkesës për energji elektrike. Nevojat e rajonit për kapacitete shtesë përllëgariten në rreth 12,000-15,00 MW, për periudhën 2013-2030. Kërkohet gjithashtu, që rreth 8,000-9,000 MW të rehabilitohen, për të plotësuar kërkesën për energji elektrike dhe për të mos u ballafaquar me kufizime të energjisë elektrike.

Zvogëlimi i diferencës ndërmjet furnizim-kërkesës me energji elektrike është thelbësor për të mbështetur një zhvillim normal ekonomik të vendeve të Europës Juglindore.

Duke njohur përftimet që rrjedhin nga një treg rajonal, krahasuar me ato që vijnë nga tregjet e veçuar nacional, lidhur me furnizimin me energji elektrike, vendet e rajonit nënshkruan Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Traktati i Komunitetit të Energjisë, i cili ka hyrë në fuqi në Korrik 2006, në të cilin vendi ynë është palë (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 03.04. 2006), inkurajon krijimin dhe integrimin e tregjeve të energjisë elektrike dhe të gazit në rajon, në kuadër të Tregut të Brëndshëm Energjetik të Komunitetit European. Aktualisht, sponsorizuar nga Banka Botërore, është përditësuar Studimi i Investimeve të Gjenerimit (GIS), i cili adoptoi kërkesat rajonale për të rritur kapacitete gjeneruese të energjisë elektrike për 15 vitet e ardhshme. Ky studim është fokusuar në furnizimin me energji elektrike të rajonit, kërkesat për burime të ardhshme elektroenergjetike dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të tyre me zhvillimin ekonomik të rajonit.

Gjithashtu, me financim të Bankës Botërore dhe të KfW është realizuar një studim për analizën e potencialeve të rritjes së përdorimit të gazit natyror, si pjesë e Studimit për Gazifikimin e Rajonit (RGS). Bazuar në GIS dhe RGS, me asistencë të USAID-it, aktualisht po punohet për zgjerimin e analizës dhe për planifikimin e hollësishëm të sistemit energjetik të rajonit. Shqipëria, si një nga vendet e rajonit, po shfrytëzon këto projekte, për njohjen e plotë të sistemeve energjetike të vendeve fqinje dhe për të rritur mundësitë për integrimin maksimal të sistemit energjetik shqiptar në atë rajonal.

Aktualisht, sponsorizuar nga Banka Botërore, është përditësuar Studimi i Investimeve të Gjenerimit (GIS), i cili adoptoi kërkesat rajonale për të rritur kapacitete gjeneruese të energjisë elektrike për 15 vitet e ardhshme. Ky studim është fokusuar në furnizimin me energji elektrike të rajonit, kërkesat për burime të ardhshme elektroenergjetike dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të tyre me zhvillimin ekonomik të rajonit.

Gjithashtu, me financim të Bankës Botërore dhe të KfW, është realizuar një studim për analizën e potencialeve të rritjes së përdorimit të gazit natyror, si pjesë e Studimit për Gazifikimin e Rajonit (RGS). Bazuar në GIS dhe RGS, me asistencë të USAID-it, aktualisht po punohet për zgjerimin e analizës dhe për planifikimin e hollësishëm të sistemit energjetik të rajonit. Shqipëria, si një nga vendet e rajonit po shfrytëzon këto projekte, për njohjen e plotë të sistemeve energjetike të vendeve fqinje dhe për të rritur mundësitë, për integrimin e sistemit energjetik shqiptar në atë rajonal dhe përfitimin maksimal prej tij.

Ky studim ndihmon në përmirësimin e strategjisë së zhvillimit energjetik dhe ekonomik të vendit, si dhe në planifikimin e investimeve të nevojshme që do të duhen në sektorin energjetik

Furnizimi me energji primare në Europën Jug-Lindore dominohet nga lëndët djegëse organike. Qymyri kontribuon në bilancin total rajonal me 31%, duke u ndjekur nga nënproduktet e naftës me 29% dhe gazi natyror me 22%. Pjesa që mbetet mbulohet nga hidroenergja, biomasa dhe energjia bërthamore. Energjia diellore dhe ajo gjeotermike japin një kontribut shumë të vogël në mbulimin e nevojave energjetike të rajonit.

Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnje Hercegovina mbështeten kryesisht në burimet hidrike për prodhimin e energjisë elektrike. Kosova, Maqedonia, Serbia, Bullgaria dhe Rumania mbështeten në termo-energjinë. Rumania, Bullgaria dhe Kroacia janë të vetmet vende në rajon, të cilat prodhojnë energjinë elektrike nga energjia bërthamore.

Vendet eksportuese të energjisë elektrike janë Bullgaria, Rumania dhe Bosnje Hercegovina, kurse vendet importuese në rajon janë Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia.

2.- VIZIONI, PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Vizioni

Qeveria Shqiptare synon të zhvillojë një sistem energjetik të mbështetur në parimet e tregut, i aftë, që të mbulojë kërkesën për energji, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me një kosto minimale sociale.

Prioritetet strategjike

Për realizimin e objektivave të strategjisë janë përcaktuar këto prioritetet:

- Përfundimi i ristrukturimit të sektorit energjetik shqiptar;
- Përsosja e mëtejshme e kuadri efektiv institucional e ligjor;
- Rritja sigurisë së furnizimit me energji të vendit,
- Rritja e kontributit të sektorit energjetik në zhvillimin ekonomik të vendit, në Buxhetin e Shtetit dhe bilancin financiar të vendit,
- Rritja e kapaciteteve gjeneruese dhe diversifikimi i tyre,
- Intensifikimi i operacioneve të kërkim-prodhimit të hidrokarbureve dhe tërheqja e investitorëve strategjikë në këtë sektor, si dhe në zhvillimin e vendburimeve ekzistuese, për të mundësuar shfrytëzimin me efektivitet dhe efikasitet të naftës bruto.
- Ndërtimi i linjave të reja të interkonjeksionit në sektorin elektroenergjetik,
- Angazhimi në realizimin e projekteve rajonale të interkoneksionit me linjat e gazit dhe diversifikimi i burimeve të furnizimit;
- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike, me konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis,
- Nxitja e përdorimit eficient dhe ekonomik të burimeve të energjisë, si dhe nxitja e aplikimit të mënyrave të ndryshme të menaxhimit të energjisë, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë
- Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë,
- Krijimi i tregut të brendshëm dhe integrimi i tij në tregun rajonal,
- Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale në sektorin energjetik,
- Përmirësimi i organizimit institucional i sektorit energjetik dhe nënsektorëve të tij (elektroenergjetik, hidrokarbur, energji të rinovueshme dhe efikasitet).

Qëllimet strategjike

Strategjia Kombëtare e Energjisë ka për qëllim të orientojë drejt zhvillimin e sektorit të energjisë nëpërmjet: liberalizimit të mëtejshëm të tregut të energjisë, nxitjes së investimeve, diversifikimit të burimeve energjetike, përdorimit me efikasitet të burimeve të energjisë dhe burimeve të rinovueshme, nxitjes dhe aplikimit të mënyrave të ndryshme të menaxhimit të energjisë, përdorimit të një sistemi fiskal nxitës për aktivitetet e sektorit energjetik, dhe tarifave reale, rritjes së konkurrencës dhe integritetit rajonal të sektorit energjetik.

Të gjitha këto do t'i shërbejnë qëllimit strategjik të rritjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe duke mbajtur një qëndrim miqësor ndaj mjedisit.

3. POLITIKAT

Për realizimin e këtij qëllimi strategjik duhet të hartohen edhe politikat e Qeverisë Shqiptare, duke e konkretizuar në akte ligjor dhe nënligjore dhe në ristrukturimin e sektorëve energjetikë, duke i përshtatur ato për t'u zhvilluar në kushtet e ekonomisë së tregut dhe në pronën private.

Politikat e Qeverisë Shqiptare duhen bazuar në Direktivat e Bashkimit Europian, si dhe në politikat për ndryshimet klimatike.

Për këtë qëllim do të realizohet:

1. Përfundimi i plotësisht dhe përafrimit të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator të sektorit energjetik, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian;
2. Përfundimi i strukturimit të shoqërive tregtare, që operojnë në sektorin energjetik;
3. Do të përfundojë privatizimi i shoqërive të prodhimit të energjisë elektrike, pronë publike, me përjashtim të hidrocentraleve Vau i Dejes, Koman dhe Fierzë mbi lumin Drin;
4. Do të përfundojë privatizimi i shoqërisë së industrisë së naftës "Albpetrol sh.a."

3.1 Skenarët

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Sektorit Energjetik është bazuar në dy skenarët referues:

1. në atë me futjen e gazit natyror dhe
2. në atë pa gaz natyror.

Për secilin prej këtyre skenarëve janë ndërtuar dy nën-skenarë zhvillimi, që marrin në konsideratë edhe angazhimet e vendit tonë, si nënshkrues i Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë, në realizimin e targeteve, për efikasitetin e energjisë dhe për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Skenarët përshkruajnë dy tendencat, brenda të cilëve ka shumë mundësi të zhvillohet sektori i energjisë. Në to pasqyrohen tendencat e sektorit energjetik shqiptar dhe atij rajonal, nevoja për diversifikimin e burimeve të furnizimit, rritja e mëtejshme e integritetit të sektorit energjetik dhe zhvillimi i një infrastrukture energjetike në nivel rajonal, rritja e liberalizimit të tregut të furnizimit me energji, zbatimin e masave të efikasitetit në degët e ekonomisë dhe arritjen e një standarti bashkëkohor në menaxhimin e energjisë, shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, kuadrin ligjor, institucional, organizativ, parashikimin e tarifave të energjisë elektrike, zhvillimet e pritshme në sektorin hidrokarbur, etj.

Skenarët e zhvillimit ekzaminojnë politika të rëndësishme energjetike, që do të përballen me vendime të politikbërësve duke përfshirë:

- Opsionet që kërkojnë sigurinë e furnizimit, për të plotësuar rritjen e kërkesës për energji në terma afat-gjatë,
- Mënyrën e rritjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike në një sistem me një dominim të hidroenergjisë,
- Mundësitë dhe opsionet financiare për të arritur targetet e Komunitetit të Energjisë dhe të Bashkimit Europian për efikasitetin e energjisë dhe menaxhimin e saj, burimet e rinovueshme dhe emetimet e CO₂. (nisma 20/20/20)

Alternativat e skenarëve që janë ndërtuar kanë në konsideratë:

Synimet për zhvillimin e Energjive të Rinovueshme (ER): Kjo politikë trajton rritjen e përdorimit të Energjive të Rinovueshme, për të arritur përdorimin e tyre në masën 39% në vitin 2020, në raport me konsumin gjithësej final të energjisë (në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë).

Synimet për rritjen e Eficencës së Energjisë (EE): Ky skenar është ndërtuar duke respektuar detyrimin që ka Shqipëria, përcaktuar nga Komuniteti i Energjisë dhe Bashkimi Europian, për rritjen deri në vitin 2018 të efikasitetit të energjisë në masën 9 %, kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë. Politika duhet të ketë parasysh që, për të realizuar këtë detyrim dhe kërkesën për energji deri në vitin 2020, të shqyrtojë programet për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuar (duke kaluar në 50% për blerjet e pajisjeve të reja me teknologji të avancuar, në krahasim me detyrimin prej 10%, që parashikohet në skenarin Referencë, pra pa ndërhyrje aktive të shtetit në sektorin energjetik)

Kombinimin e Politikave të ER dhe EE: Ky kombinim, si në këndvështrimin për realizimin e furnizimit, ashtu dhe për kërkesën, shqyrton rezultatet sinergjike të të dy këtyre faktorëve.

Lidhjen e Shqipërisë me rrjetin rajonal të Gazit Natyror: Skenari Referues supozon zhvillimin e sektorit energjetik, duke patur parasysh që deri në vitin 2018, rrjeti shqiptar i gazit nuk do të jetë i lidhur në rrjetin rajonal të gazit. Projekti TAP, sipas skenarit, pritet të bëhet efektiv pas vitit 2018. Vlen të përmendim, që sekenarët marin parasysh edhe alternativa të tjera të furnizimit të vendit tonë me gaz natyror si nga Maqedonia, Greqia dhe Mali i Zi. (projekti IAP, Unaza e Gazit të Ballkanit Perëndimor, etj.)

Skenari referues është ndërtuar duke u bazuar në zhvillimet aktuale të vendit tonë, si dhe në parametrat bazë të zhvillimit makroekonomik të vendit tonë. Ai supozon që një pjesë e madhe e kërkesës së ardhshme për energji elektrike do të mbulohet nga zgjerimi i kapaciteteve gjeneruese termike (bazuar tek dizeli i marinës, solari, mazuti ose gazi natyror i importuar) dhe hidroenergjetika. Produktet e naftës do të kenë dominimin kryesor në bilancin energjetik. Supozimi në këtë skenar lidhet me ecurinë aktuale, ku targetet e sektorit energjetik nuk zbatohen në mënyrë rigorozë.

Në këtë analizë është marre si vit bazë viti 2006, në mënyrë që të shihet edhe tendenca e zhvillimit të sektorit energjetik dhe të ekonomisë, mbështetur në një konsum real të viteve të fundit.

Tabela 2 Treguesit kryesorë të skenarit referencës

Treguesit	2006	2020	2030	Rritja vjetore (%)	Rritja e përgjithshme (%)
Energjia Primare (Ktoe)	2215	3481	4550	3.0%	105.5%
Energji Finale (Ktoe)	1826	3252	4206	3.5%	130.3%
Kapaciteti i Impjanteve (MW)	1.492	2915	3484	2.8%	92.3%
Importet (Ktoe)	1017	2068	2793	4.3%	174.5%
Emetimet CO ₂ (Kt)	3796	6478	8977	3.7%	136.5%
GDP (€ Mill.)	7200	19099	29671	6.1%	312.1%
Popullsia (000s)	3150	3544	3732	0.7%	18.5%
Intesiteti final i energjisë (toe/€000 GDP)	0.254	0.209	0.142	-2.4%	-44.1%
Intesiteti final për banorë (toe/Capita)	0.580	0.850	1.127	2.8%	94.4%

3.1.1 Zhvillimi i sektorit energjetik sipas skenarit ku merret në konsideratë dhe rritja e efikasitetit të energjisë

Skenari, që merr në konsideratë edhe efektin e Efikasitetit të Energjisë, është bazuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë (PKVË), aprovuar nga Qeveria Shqiptare në shtator 2011, i cili mbështetet në Direktivën e Bashkimit Europian: 2006/32/EC mbi "Përdorimin me efikasitet të energjisë për përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike", Direktivën 2002/91/EC "Përfomancat energjetike në ndërtesa" (amenduar me Direktivën 2010/31/EP), Direktivën 92/75/EC (e amenduar me Direktivën 2010/30/EP).

Skenari ka analizuar dhe llogaritur masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e Efikasitetit të Energjisë në sektorët e ekonomisë, të planifikuara me qëllim realizimin e objektivave të E për periudhën afatshkurtër, për periudhën afatgjatë 2018, dhe deri në vitin 2030, nëpërmjet zbatimit të politikave për rritjen e Efikasitetit të Energjisë.

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët ekonomik është dhe një nga qëllimet kryesore të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Energjisë.

Skenari merr parasysh problemet më të rëndësishme me të cilat do të përballet në të ardhmen zhvillimi ekonomik i vendit dhe sektori energjetik në veçanti, të tilla, si rritja e konsumit të energjisë për banorë dhe mbajtja në të njëjtën kohë e një niveli relativisht më të ulët të intesitetit të energjisë.

Intesiteti i energjisë në Shqipëri konsiderohet i lartë krahasuar me vendet e rajonit, për rrjedhojë, sektori i energjisë në Shqipëri do të vazhdojë të përballet me dy sfida të rëndësishme: (i) mbajtjen e këtij intesiteti në nivele mesatare, dhe (ii) rritja e konsumit të energjisë për banorë (rritjen e komoditetit të jetës).

Skenari i efikasitetit të energjisë është i lidhur ngushtë me zbatimin i PKVË-it, i cili është në fazën fillestare të implementimit të politikës kombëtare për efikasitetin e energjisë. Natyrisht, në këtë periudhë duhen zgjidhur disa probleme dhe mangësi, që rezultojnë nga moszbatimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e efikasitetit të energjisë.

Për këtë kërkohet:

- Adoptimi i kuadrit ligjor e nënligjor për Efikasitetin e Energjisë, në harmoni me Direktivat e Bashkimit Europian;
- Zbatimi i përpiktë i kuadrit ligjor mbi "Efikasitetin e Energjisë" dhe i Planit të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë;
- Nxitjet dhe mbështetjet financiare për investime për Efikasitetin e Energjisë;
- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese;
- Hyrja në treg i kompanive të shërbimit për zbatimin e masave për Efikasitetin e Energjisë.

Bazuar në analizat dhe supozimet e mësipërme, është llogaritur norma prej 3% e kursimit të energjisë, pra, rritja e efikasitetit të energjisë në 2012 dhe 9% në 2018, dhe më pas 15% deri në vitin 2030.

Tabela 3, paraqet kursimin e energjisë sipas PKVË dhe pas viteve 2018, kursimet do të kenë ecuri sipas targeteve të BE-së.

Tabela 3 Ecuria e kursimeve sipas Planit të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë

	2012	2015	2018	2020	2024	2027	2030
Targeti i PKVË	3.0%	6.0%	9.0%	12.0%	15.0%	15.0%	15.0%
Kursimi (ktoe)	55	109	168	219	273	273	273

Nisur nga rëndësia e sektorëve si dhe nga rezultatet e llogaritjes së skenarit, ku merret në konsideratë dhe efica e energjisë, janë parashikuar dhe masat që duhen të ndërmerren sipas sektorëve të ekonomisë.

Në sektorin e Banesave politikat energjetike karakterizohen nga një sërë instrumentash, që duhen aplikuar në aspekte të ndryshme të përdorimit të energjisë në banesa. Këto instrumenta kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin me efica e kursimin e energjisë, si dhe në adresimin e rregullave për ndërtimin e ndërtesave të reja apo rinovimin e tyre.

Me objektivin për reduktimin e konsumit të energjisë, sipas normave të përcaktuara më sipër, më poshtë jepen masat kryesore, sasiore dhe cilësore, që nevojiten të merren në konsideratë për vitet në vazhdim:

- Izolimi termik i stokut ekzistues të banesave, që do të kontribuojë në reduktimin e energjisë elektrike dhe druve të zjarrit për ngrohjen e hapësirave të banimit, në kuadër të aplikimit të kërkesave minimale mbi cilësinë termike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese.
- Njohja dhe përdorimi i skemave të ngrohjes qëndrore dhe lokale, që do të kontribuojnë në ngrohjen e hapësirave dhe ujit të ngrohtë sanitar, veçanërisht në ndërtesat e reja shumëkatëshe.
- Përdorimi i sistemeve diellore për plotësimin e kërkesës për energji me ujë të ngrohtë sanitar, i cili do të reduktojë konsumin e energjisë elektrike të përdorur për këtë qëllim.
- Përdorimi i pajisjeve elektrike të etiketuara dhe me efica të lartë të përdorimit të energjisë;
- Përdorimi më i madh i llampave efica, të cilat do të reduktojnë energjinë elektrike të konsumuar për ndriçim;

Sipas kësaj pakete masash, në sektorin e banesave llogaritet një kursim vjetor i energjisë me 37 (ktoe) deri në vitin 2018, dhe në nivelin 48.2 ktoe në vitin 2020.

Në sektorin e shërbimeve masat që do të ndikojnë në reduktimin e konsumit të energjisë do të jenë: zbatimi i Kodit Energjetik të ndërtesave, në stokun ekzistues dhe në ato të reja të ndërtesave publike dhe private, aplikimi i iniciativave fiskale për burimet e rinovueshme të energjisë dhe burimet e tjera efica, izolimi termik, ndriçimi efica, pajisjet elektrike efica, politikat fiskale për përdorimin e energjive, fushatat ndërgjegjësuere, etj.

Masat më të rëndësishme jepen më poshtë:

- Depërtim i ndjeshëm i produkteve të gazit të lëngët të naftës për ngrohjen e hapësirave dhe kërkesës energjetike për ujë të ngrohtë;
- Përmirësim i izolimit termik në stokun e ndërtesave ekzistuese publike dhe private të sektorit të Shërbimeve dhe aplikim rigoroz i Kodit të Energjisë në Ndërtesa, në ndërtesat e reja; Rregullore teknike mbi performancën energjetike të ndërtesave dhe zbatimi i tyre në praktikën e ndërtimit, zgjerim i përdorimit të sistemeve diellore, për përgatitjen e ujit të ngrohtë në ndërtesat publike dhe tregtare të këtij sektori;
- Penetrim gradual i impianteve të vegjël CHP dhe skemat e ngrohjes qëndrore për konsumatorët e mëdhenj e të vegjël (spitalet, konviktet, hotelet, etj.), veçanërisht nëpërmjet zëvendësimit të sistemeve ekzistues konvencional;
- Kryerja e auditimeve energjetike në ndërtesat publike dhe private të sektorit të Shërbimeve (spitale, konvikte, hotele, etj.) dhe qëndrat e mëdha tregtare dhe hoteleri; inspektimet e detyrueshme të ngrohjes, ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar dhe zbatimi i masave të Eficasë së Energjisë pas kryerjes së auditimeve.

Sipas kësaj pakete masash, në sektorin e shërbimeve, llogaritet një kursim vjetor i energjisë me 32 (ktoe) deri në vitin 2018, dhe në nivelin 41.7 ktoe në vitin 2020.

Sektori i Industrisë për një zhillimi të qëndrueshëm kërkon plotësimin e kërkesave me energji në çdo nënsektor industrial (në sasi, cilësi, çmim, siguri dhe kohë). Ky sektor parashikon të luajë një rol të ndjeshëm në rritjen ekonomike, punësimin, rritjen e standartit të jetës, etj.

Masat e veçanta të dhëna më poshtë janë rekomandimet kryesore për reduktimin e konsumit të energjisë në sektorin e Industrisë:

- Përmirësimi i menaxhimit;
- Mirëmbajtje dhe modernizim i teknologjive;
- Njohje e koncepteve: “teknologji e pastër”, “bashkimi i disa industrive”
- Përmirësimet teknologjike, sistemet e kondicionimit të ajrit, ventilimit, etj.
- Eleminimi, sa më shumë të jetë i mundur, i qëndrimeve të pajisjeve elektrike në “stand-by”.
- Rritja e cos fi-së

Sipas kësaj pakete masash, në sektorin e industrisë, llogaritet një kursim vjetor i energjisë me 42 (ktoe) deri në vitin 2018, dhe në nivelin 54.7 ktoe në vitin 2020

Sektori i Transportit konsumon pothuajse 44% të totalit të konsumit final të burimeve të energjisë. Transporti ka njohur rritje të aktivitetit të tij në vitet e fundit. Pjesën dominuese në këtë sektor e zë transporti rrugor me 86%, kundrejt totalit 4% të transporti hekurudhor, 4% transporti detar dhe 6% transporti ajror. Tendenca e transportit publik pritet të jetë në rritje, duke patur parasysh për më tepër, politikat për rritjen e kontributit të transportit publik rrugor dhe atij hekurudhor në të ardhmen.

Sasia e energjisë së kursyer do të jetë rezultat jo vetëm i masave që parashikohen por dhe të fushatave të sensibilizimit, të cilat duhet të ndikojnë në qëndrime të reja kundrejt përdorimit të llojeve të transportit, duke parë me përparësi përdorimin e transportit publik, ndryshimin e parkut të automjeteve, etj.

Për të arritur objektivat e parashikuara për kursimin e energjisë në sektorin e transportit janë parashikuar këto masa:

- Ndërtimi i rrugëve të reja,
- Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese, të cilat tashmë janë në proces përmirësimi,
- Përshtatja e kuadrit ligjor në përputhje me Direktivat e BE, për etiketimin e automjeteve sipas klasave A-G, në përputhje me nivelin e emetimeve të CO₂. Kjo duhet të përbëjë detyrim për të gjithë tregtuesit e automjeteve, për të bërë prezente etiketimet tek konsumatorët,
- Rritja e kontributit të transportit publik,
- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit hekurudhor me qëllim rritjen e përdorimit dhe shfrytëzimit të këtij opsioni shumë të leverdisshëm,
- Paraqitja e taksave mjedisore për emetimet nga automjetet dhe pagesa e tyre në momentin e regjistrimit dhe të kolaudimit të automjeteve,
- Përdorimi në mënyrë racionale dhe eficiente të automjetit nga pikëpamja e dhënies së makinës.

Sipas kësaj pakete masash, në sektorin e transportit, llogaritet një kursim vjetor i energjisë me 52 (ktoe) deri në vitin 2018, dhe në nivelin 67.7 ktoe në vitin 2020

Sektori i bujqësisë vazhdon të mbetet sektori me peshën specifike më të madhe në Shqipëri, në vlerën rreth 43% të totalit të GDP. Shqipëria do të vazhdojë të mbetet një vend me dominim të prodhimit bujqësor. Konsumi i energjisë në këtë sektor mbetet një alternativë e konsiderueshme për zhvillimin ekonomik dhe social. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë është kushtëzuar nga shumë faktorë të cilët janë:

- Ferma të vogla dhe të fragmentizuara,

- Probleme që ndeshen në pronësinë e tokave,
- Çmime të larta të produkteve në tregun me pakicë;
- Prodhim dhe shpërndarje jo efektive dhe e paorganizuar e produkteve bujqësore dhe blegtorale
- Mungesa e kreditimeve në bujqësi,
- Mungesa e mekanizimit bujqësor,

Me objektivin për reduktimin e konsumit të burimeve energjetike në vlerën e 5Ktoe, janë parashikuar këto masa sasiore dhe cilësore:

- Aplikimi i skemave të biomasës dhe të prodhimit të biogazit nga impiantet përkatëse në mënyrë efektive.
- Përdorimi i skemave efçente të ujitjes, (në formë shiu).

Sipas kësaj pakete masash, në sektorin e bujqësisë, llogaritet një kursim vjetor i energjisë me 5 (ktoe) deri në vitin 2018, dhe në nivelin 6.5 ktoe në vitin 2020

Investimet e nevojshme

Skenari llogaritet që investimet afat-shkurtëra në total për të gjithë sektorët e analizuar, me zbatimin e masave të efçencës, parashikohet të jetë në vlerën rreth 6,7 milion Euro deri në vitin 2018, dhe që do të shkojnë në rreth 8.72 Milion Euro në vitin 2020.

Ai, gjithashtu promovon politika për rritjen e efçencës së energjisë, të cilat do të japin ndryshimet krahasuar me skenarin referues si më poshtë.

- Skenari i efçencës së energjisë redukton me 1.3% ose (568 €Million) koston e sistemit energjetik,
- Skenari redukton me 8% importet ose në vlerë (4 145 ktoes) referuar targetet e PKVEE në rritjen e sigurisë së energjisë;
- Skenari redukton konsumin final të energjisë në 7.3%, ose 5483 ktoes, si dhe redukton emetimet e CO₂ me 7.2% (ose 11,781 Kt).

3.1.2 Zhvillimi i sektorit energjetik sipas Skenarit që merr në konsideratë ndikimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë dhe të Efçencës së Energjisë (Skenari RE&EE)

Skenari RE&EE merrë në konsideratë, veç ndikimit të efçencës së energjisë edhe ndikimin e zhvillimit të burimeve të rinovueshme. Kjo do të kërkojë ndërhyrjen aktive të Qeverisë Shqiptare me politika stimuluese për sektorin energjetik. Këto ndërhyrje synojnë në: përmirësimin e kuadrit institucional, ligjor dhe regullator të sektorit, duke orientuar investimet për një shfrytëzim efçient të kapitaleve publike dhe private.

Reduktimi i kërkesës për energji në këtë skenar është llogaritur duke mbajtur të njëjtët parametra të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit si në skenarin referues.

Vlerësimi i tij nxjerr në dukje se cilat janë impaktet e mungesës së rrjetit të gazit në Shqipëri dhe janë si më poshtë:

- Mungesa e gazit do të çonte në rritjen e kostove në sistemin energjetik, e llogaritur në 411 M€ ose 3.1% , krahasuar me Skenarin Referues të gazit.
- Rritja e koston, që vjen nga investimet e reja, për TEC-et me bazë lëndë djegëse fosile të rendit 1000 MW, baraz me shtesën kumulative të investimeve të kërkuara me 1,685 M€.

- Ky zgjerim i sistemit të gjenerimit është në përgjigje të rritjes së kërkesës për energji elektrike në sektorët ekonomik, të cilët janë të varur shumë nga gazi (pas 2021) në rastin e skenarit Referues.
- Importet rriten me mbi 5.6% krahasuar me skenarin Referues. Kjo ndodh për shkak të prodhimit të energjisë nga lëndët djegëse fosile, por edhe si pasojë e rritjes së nevojës për LPG dhe produkteve të tjera të naftës, të cilat do të ndikonin në rritjen e shpenzimeve kumulative me një vlerë prej rreth 250 Meuro në vit.
- Emëtimet e CO₂ rriten me mbi 20% nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë elektrike.

Skenari i RE dhe EE mbështet dhe nxit objektivat e mëposhtme:

- Rritjen e sigurisë së furnizimit;
- Diversifikimin e furnizimit me burime energjetike;
- Rritjen e efikasitetit të energjisë;
- Rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- Vendosja e çmimeve reale të energjisë elektrike që mbulojnë kostot;
- Operimin në tregun rajonal të energjisë elektrike;
- Lidhjen e vendit me rrjetet rajonale të gazit dhe naftës;
- Mbrojtjen e mjedisit.

Ky skenar ka në qendër të vëmendjes së tij rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe efikasitetin e përdorimit të energjisë, si komponent mbështetës për zhvillimin e një sektori energjetik duke respektuar standartet mjedisore.

Skenari RE&EE kërkon një kuadër ligjor dhe organizativ bashkëkohor dhe të bashkërenduar, jo vetëm me zhvillimet brenda vendit, por dhe me ato rajonale, duke tentuar në plotësimin e detyrimeve tona, të përcaktuara në Traktatin e Energjisë dhe në harmoni me direktivat e Bashkimit Europian.

Skenari mbështet targetet e vendosura nga Plani Kombëtar i Burimeve të Rinovueshme dhe të harmonizuar nga Komuniteti i Energjisë, ku kontributi i burimeve të rinovueshme në raport me konsumin e përgjithshëm final të energjisë (GFEC) është parashikuar të jetë 39 % deri në vitin 2020.

Targeti është vendosur bazuar në direktivën e Bashkimit Europian për Burimet e Rinovueshme dhe i është referuar dy elementeve të rëndësishëm: konsumin total final të energjisë (GFEC) për vitet 2009 dhe 2020, të cilat janë respektivisht 1895.13 ktoe dhe 3355.9 ktoe.

Skenari i Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Eficencës së Energjisë është mjaft i rëndësishëm për vendin tonë, pasi realizimi i tij do të përmbushi dy objektiva strategjik: sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit. Si do qoftë, në targetet për burimet e rinovueshme, vendi ynë është një rast i vecantë, pasi prodhimin më të madh të energjisë elektrike e siguron nga burimet hidrike.

Bazuar në këta tregues, në figurën e mëposhtme kemi përcaktuar, brenda Direktivës së Shërbimit të Energjisë, shpërndarjen e konsumit sipas sektorëve. Ajo paraqet kërkesën për energji, ku industria do të mbulojë 16.5 %, transporti 42 %, sektori rezidencial 27.1 %, sektori i shërbimit 14.34 % dhe bujqësia 4.59 %.




Figure 7.: Konsumi final i energjisë dhe kërkesa finale e energjisë për Shqipërinë deri në vitin 2030 bazuar në skenarin referues.

Skenari i burimeve të rinovueshme dhe eficesës së energjisë (skenari RE&EE) përqëndrohet në harmonizimin e çështjeve më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe të sektorit të energjisë, që janë rritja e konsumit të energjisë për banorë dhe mirëqenja.

Në të njëjtën kohë, përmirësimet në konsumin e energjisë, për një intesitet të ulët të energjisë, do të krijojë një ekonomi efikase dhe konkurruese në tregun ndërkombëtar të energjisë. Intesiteti i energjisë i Shqipërisë është më i larti në rajon. Në këtë tregues vendi ynë vjen pas Bullgarisë. Si pasojë, sektori i energjisë në Shqipëri do të vazhdojë të përballet me dy sfida të rëndësishme: (i) ruajtja e këtij intensiteti në nivele mesatare, dhe (ii) rritja e konsumit të energjisë për frymë.

Në implementimin e këtij skenari rol të rëndësishëm ka zbatimi i Planit Kombëtar të Eficencës së Energjisë (PVKEE) dhe i Burimeve të Rinovueshme të Shqipërisë, të cilët janë në fazan fillestare të implementimit, dhe përmbushja e tyre lidhet me dy detyra kryesore:

- Miratimin e kuadrit të plotë ligjor të eficesës së energjisë dhe burimeve të rinovueshme;
- Zbatimi i drejtë i kuadrit ligjor në Planin e Veprimit;

Bazuar në eksperiencën e vendeve në zhvillim kemi llogaritur kërkesën finale të energjisë pa dhe me Eficencë Energjie dhe ne figuren 8 dhe 9 jepen tendencat, duke marrë në konsideratë kursimin e energjisë sipas targeteve për çdo sektor. Analiza e këtyre tendencave paraqet kursimin e energjisë sipas (PKVEE) për të aritur objektivin 9 % të vendit tonë në vitin 2018 dhe 15 % në vitin 2020.




Figura 8.: Ecuria e Kërkesës totale finale e energjiëe pa dhe me eficencë energjie bazuar në PKVË dhe RE




Figure 9. Ecuria e Targeteve të Eficencës së Energjisë në % sipas PKVË dhe PKVBR

Skenari, ku merret në konsideratë ndikimi i shfrytëzimit të Burimeve të Rinovueshme dhe i Eficencës së Energjisë është ndërtuar duke marrë në konsideratë direktivën 2009/28/EC, e cila paraqet kontributin e burimeve të rinovueshme në vitin 2020 sipas sektorëve, kryesisht për transportin, energjinë elektrike si dhe për ngrohje dhe ftohje, të cilat parashikohen të jenë repektivisht 105.42 ktoe, 390.89 ktoe dhe 759.88 ktoe.

Sipas skenarit RE&EE, deri në vitin 2020 është e nevojshme të instalohet një kapacitet energjetik shtesë prej rreth 1328 MW, prej të cilave rreth 1208 MW bazuar në prodhimin hidrik dhe rreth 120 MW nga prodhimi termik. Po sipas këtij skenari do të duhet të prodhohen rreth 10443 GWh energji elektrike.

Kërkesa për investimet totale në sektorin e energjisë elektrike, në periudhën 2009-2020 arrin në rreth 2471 Milion Euro, ku hidrocentralet e vegjël kapin një vlerë investimi 785 milion Euro. Analizat e mësipërme janë bërë duke u bazuar në burimet e reja gjeneruese, që duhet të ndërtohen në Shqipëri me financime të investitorëve privatë. Në mbështetje të këtij koncepti tashmë janë në fazë implementimi ose janë mbyllur procedurat e lidhjes së kontratave, për kaskadën mbi lumin Devoll, me kapacitet 270 MW, ndërtimin e HEC-it të Ashtës me kapacitet 48 MW dhe janë në fazën finale hapja e garës për ndërtimin e Hec-eve në kaskadat e lumenjve Osum dhe Vjosa. Gjithshtu, është në progres dhe projekti për ndërtimin e HEC-it të Skavicës mbi lumin Drini i Zi.

Vlen të përmendet, që deri tani janë lëshuar 112 kontrata koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve të kategorive të ndryshme, me fuqi totale rreth 1400 MW, ku hidrocentralet e vegjël kontribuojnë me 839 MW.

Skenari RE&EE merr në konsideratë edhe furnizimin me gaz pas vitit 2018, duke vënë në qendër të vëmëndjes kryesisht projektin TAP dhe projektin IAP, si dhe alternativat e furnizimit nga vëndet fqinje, Maqedonia, Greqia dhe Mali i Zi, nëpërmjet projektit të Unazës së Gazit të Ballkanit Perëndimor.

Gazi natyror si fillim parashikohet të jëtë i mundshëm për përdorim në industritë e mëdha dhe në TEC-e. Më pas, gazi natyror do të konsumohet në të gjithë sektorët e tjerë. Parashikohet që penetrimi i tij në sasi të mëdha, për sektorët rezidencial dhe komercial të fillojë në mes të vitit 2020, për shkak të investimeve të mëdha, që kërkohen për ndërtimin e rrjetit të shpërndarjes së gazit deri në vitin 2030. Gazi natyror në këtë skenar llogaritet në 37% të konsumit final të energjisë. Kërkesa e gazit natyror për tregun shqiptar parashikohet të arrijë rreth 1.6 miliard m³. Shqipëria, si vend pjesmarrës i Komunitetit të Energjisë, mbështet projektin e Komunitetit të Energjisë për unazën e gazit natyror të Ballkanit, e cila do të këtë një ndikim të rëndësishëm, sidomos në vendet si Shqipëria, Kosova, Mali i Zi të cilat akoma nuk janë lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit.




Figura 10 Ecuria e kërkesës për Gaz Natyror deri në vitin 2030

Skenari mbështet, gjithashtu, nxitjen dhe promovimin e investimeve për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjen e mjedisit. Në vlerësimet për mbulimin e nevojave energjetike për vitin 2020 (skenari e burimeve të rinovueshme dhe i efikasitetit të energjisë), kontributin kryesor do ta mbajnë lëndët djegëse fosile me 62.4%, hidroenergjinë 27.03%. Kurse në këndvështrimin e përdorimit të energjive konvencionale dhe atyre të përfuqara nga burimet e rinovueshme parashikohet që nga këto të fundit të mbulohen rreth 38% të nevojave për energji, ku kontributi nga drutë e zjarrit parashikohet të jetë 18.53%, transporti 8.93 % dhe pjesa tjetër do të mbulohet nga burimet e tjera të energjive të rinovueshme.

Bazuar në rezultatet e skenarit RE&EE vërejmë se:

- Për të shtuar kapacitetet e reja prej 1328 MW në vitin 2020 dhe 1596 MW në 2030, kërkohet një investim total prej 2471 M€, i cili përkthehet në një mesatare, 100M € në vit.
- Mbi 400M€ në vit do të duhen për të mbuluar koston e paisjeve të reja të kërkuara deri në vitin 2030.
- Pagesat vjetore për lëndë djegëse primare do të rriten në 1034M€/vit në 2030, dyfishi i vlerës aktuale.
- Në Skenarin RE&EE emetimet e CO₂ janë tre herë më të ulta se Skenari Referues
- Konsumi për Frymë të CO₂ në skenarin RE&EE është 0.55 tonCO₂/banor nga 1.40tonCO₂/banor të Skenarit Referues
- Kursimi i energjisë llogaritet 276 Ktoe krahasuar me skenarin Referues.

Ky skenar mbështet gjithashtu, i koordinuar me **masterplanin e transmetimit** dhe shpërndarjes, reduktimin e humbjeve, procesin e ristrukturimit dhe privatizimit të sektorit të energjisë, liberalizimin e tregut të energjisë, etj.

Niveli i humbjeve teknike në sistemin elektroenergjetik, si rezultat i investimeve të parashikuara për t'u realizuar, në vitin 2020 parashikohet të shkojë në rreth 8%.

Në sistemin e transmetimit parashikohet të ndërtohen objekte shumë të rëndësishme, si për rritjen e kapaciteteve të importit apo të shkëmbimit të energjisë elektrike, ashtu dhe për menaxhimin e flukseve, për ta kthyer Shqipërinë në një nyje të rëndësishme të transmetimit të energjisë elektrike, si në drejtimin jug-veri, ashtu dhe në drejtimin lindje-perëndim.

Disa nga investimet kryesore në sistemin e transmetimit, që tashmë janë në fazë implementimi ose që parashikohen të ndërtohen në këtë periudhë janë: ndërtimi i linjave të tensionit të lartë 400 kV Tiranë - Prishtinë, Maqedoni - Shqipëri; Shqipëri-Itali, si dhe fuqizimi i të gjithë nënstacioneve 400 dhe 220 kV të sistemit tonë energjetik.

Skenari, ku merret në konsideratë dhe ndikimi i burimeve të rinovueshme, mbështetet në një reformë të plotë, që po ndërmerret nga Qeveria Shqiptare, për nxitjen e përdorimit të energjive të rinovueshme dhe në realizimin e targetit të përcaktuar për t'u arritur deri në vitin 2020 në përdorimin e energjive të përfuara nga burimet e rinovueshme.

Në këtë reformë përfshihen:

- Ligji i ri "Për energjitë e rinovueshme"
- Plani Kombëtar i Veprimet për Energjitë e Rinovueshme;

Në skenarin RE&Ë **për sektorin hidrokarbur** gjejnë pasqyrim zhvillimet e fundit të këtij sektori si dhe perspektiva.

Zhvillimi i Sektorit Hidrokarbur

Politikat për zhvillimin e sektorit të naftës dhe gazit do të synojnë në diversifikimin e furnizimit me naftë dhe gaz dhe mundësimin e lidhjes së Shqipërisë me rrjetet fqinje të naftës-jellsave dhe gazsjellsave, si dhe një mbështetje të plotë të zbulimeve të reja të burimeve energjetike hidrokarbure në vend dhe si rrjedhojë rritje e nivelit të brëndshëm të prodhimit të naftës dhe gazit.

Zhvillimi në të ardhmen i një strategjie të furnizimit me gaz nga disa burime furnizimi për Shqipërinë duhet të bazohet në lidhjen dhe furnizimin nga Rajonet e Detit Kaspik, Lindjes së Mesme, Rusia dhe Europa Qëndrore përmes Kroacisë.

Politikat dhe planet e Qeverisë Shqiptare për interkoneksionin e rrjeteve të gazit dhe të naftës janë konkretizuar me mbështetjen e disa projekteve të interkoneksionit me vëndet fqinje dhe rajonin e Europës Jug-Lindore, nëpërmjet përfshirjes në projektet rajonale në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe të marrëveshjeve ose konventave bilaterale dhe multilaterale për projekte të veçanta ose për sektorin energjetik në përgjithësi.

Në konceptin e politikave zhvilluese të sitemit të tubacioneve të transportit të hidrokarbureve, si dhe të lidhjeve rajonale me këto sisteme, vlerësohet se lidhja e Shqipërisë me rrjetin rajonal dhe European të naftës dhe vecanërisht të gazit, do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend,, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në rritjen e sigurisë së furnizimit me burime energjetike, si dhe në raportet e përdorimit të energjive, ku deri më sot, ngarkesa kryesore i takon produkteve të naftës bruto dhe energjisë elektrike.

Pavarësisht nga studimet e shumta, vëndi ynë ende nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Në kuadër të diversifikimit të burimeve të energjisë, si dhe të zhvillimit të sektorit energjetik, Qeveria Shqiptare është tepër e interesuar për zhvillimin e infrastrukturës rajonale të gazit, dhe para së gjithash për futjen e Gazit Natyror në Shqipëri dhe lidhjen e vëndit me rrjetet e gazit Rajonale dhe Ndërkombëtare.

Shqipëria është pjesë e Studimit Rajonal për Gazifikimin, të financuar nga BB dhe KfW dhe në këtë kuadër si pjesë e rajonit të Europës J-L dhe anëtare e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë ka qenë dhe është e interesuar për lidhjen e saj me rrjetet Rajonale të gazit, në përputhje me variantin më të mirë dhe në këtë kuadër, vendi ynë ka mbështetur konceptin e Unazës së Gazit për Ballkanin Perëndimor (Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë), e propozuar nga konkluzionet e këtij studimi.

Aktualisht vendi ynë është përfshirë në projekte të lidhjeve rajonale të sistemeve të gazit, që kanë marrë një vlerësim konkret nga strukturat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, por edhe nga Brukseli, sikurse është projekti i Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë, që parashikohet të lidhë pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, Shqipëria është pjesë e projektit të Gazsjellsit Jonian Adriatik (projekti IAP), projekt, i cili do të lidhë vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi dhe Shqipëria, si dhe Bosnje&Hercegovina, si dhe e projektit të gazsjellsit lindje-perëndim Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP – Greqi – Shqipëri – Itali), që parashikohet të sjellë gazin e rajoneve të Lindjes së Mesme, Kaspikut dhe Ruisë drejt Europës Perëndimore. Një projekt tjetër, për lidhjet rajonale me gazsjellsat, është projekti i ndërtimit të një terminali të Gazit Natyror të Lëngëzuar në bregdetin e Qarkut të Fierit dhe lidhja me rrjetin Italian të gazit (dhe rrjetin European) me një gazsjellës nëndetar Shqipëri - Itali.

Privatizimi i Sektorit të Naftës dhe Gazit

Privatizimi në sektorin e kërkim - prodhimit ka qenë i konceptuar të realizohet nëpërmjet dhënies të së drejtës për shfrytëzim të vendburimeve ekzistuese, mbi bazën e marrëveshjeve hidrokarbure. Kështu, pjesa më e madhe e vendburimeve ,janë dhënë për zhvillim në këtë formë.

Aktualisht është duke u realizuar procesi i privatizimit të plotë të shoqërisë publike ALBPETROL sh.a., për të cilën është miratuar edhe kuadri ligjor dhe nënligjor përkatës.

Zhvillimi i Tregut të Naftës, Gazit dhe Produkteve të tyre

Tregtimi i produkteve hidrokarbure, bazuar në një treg të hapur dhe të liberalizuar, ku sektori privat është dominant.

Lidhja e vendit me rrjetet ndërkombëtare të naftës dhe gazit, duke i paraprirë me kuadrin institucional dhe ligjor, bazuar në direktivat e Bashkimit European dhe në kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Ndërtimi i infrastrukturës bregdetare të import-eksportit dhe depozitimit të naftës dhe nënprodukteve të saj, të përqëndruara kryesisht në dy zona, në atë të Vlorës dhe të Porto-Romanos.

Efiçenca energjisë

Skenari i burimeve të rinovueshme dhe i efiçencës së energjisë mbështet promovimin e efiçencës së energjisë, si një faktor i rëndësishëm për rritjen e sigurisë së furnizimit të energjisë, mbrotjen e mjedisit, rritjen e efektivitetit të burimeve të energjisë, përmes zbatimit të një sistemi masash dhe aktiviteteve të parashikuara në anën e furnizimit dhe të konsumit.

Nga krahasimi i rezultateve të dy skenarëve, rezulton që energjia totale e kursyer në të gjithë sektorët deri në vitin 2020, parashikohet të jetë 219 ktoe dhe në vitin 2030 në 273 ktoe.

Skenari kërkon zbatimin e ligjeve “Për burimet e rinovueshme” dhe “Për efiçencën e energjisë”, si deklara ligjore kyç për implementimin e “Planit Kombëtar të Veprimeve të Efiçencës së Energjisë” dhe “Planin Kombëtar të Veprimeve të Burimeve të Rinovueshme”, të cilat janë dy dokumenta të rëndësishme për zbatimin e skenarëve të Strategjisë Kombëtare të Energjisë.

3.2 Ristrukturimi institucional i Sektorit Energjetik Shqiptar

Implementimi i kësaj strategjie, do të kërkojë institucione të qëndrueshme, me kapacitete të nevojshme profesionale, por mbi të gjitha me një mentalitet menaxhimi eficient për sektorin.

3.2.1 Organizimi i institucioneve

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës do të vazhdojë të luajë rolin kryesor në hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit të energjisë dhe në të njëjtën kohë, duke qenë përfaqësuese e të drejtës së pronësisë së shtetit mbi shoqëritë publike të sektorit të energjisë, ajo do të vazhdojë të jetë përgjegjëse për mirëmenaxhimin e këtyre shoqërive deri në privatizimin e mundshëm të tyre.

Sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare kërkojnë një përmirësim të menaxhimit të burimeve dhe të konsumit të energjisë. Ndërtimi i një strukture të plotë të politikave energjetike dhe të atyre për menaxhimin e energjisë, si dhe i strukturave, që realizojnë rolin rregullator të shtetit në këtë sektor, do të krijojnë mundësi monitorimi më eficient të sektorit të energjisë.

Në kuadër të përmirësimit të punës së strukturave, që merren me problematiken e energjisë, mund të jëtë e nevojshme ristrukturimi i disa prej këtyre veprimtarive, në mënyrë, që të mos ketë mbivendosje, por as boshllëqe në këto struktura dhe të gjitha në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian, për këtë sektor.

Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, Ligji Nr.7746, dt. 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkim dhe prodhim)”, i ndryshuar, Ligji nr 9946, datë 30.06.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” kërkojnë një rritje të rolit të METE-s, si një institucion shumë i rëndësishëm, i cili përcakton drejtimet dhe mekanizmat e zhvillimit të strukturave të energjisë, realizon procedurat e dhënjes së lejeve koncesionare e autorizimeve në këtë sektor, etj.

Në përputhje me vizionin strategjik të Qeverisë, për realizimin e një reforme të thellë dhe të plotë rregullatore, gjatë periudhës 2006 - 2011 janë ndërmarë hapa konkrete për thjeshtimin, shkurtrimin e uljen e kostos në lejet dhe autorizimet, që jepen për ushtrimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë.

Në këtë kuadër, i është kushtuar vëmendje e veçantë përsojës së procesit të monitorimit, funksion i AKBN, që do të përbëjë një element shumë të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të energjisë, për periudhën në vazhdim.

Gjithashtu, për të shkurtuar kohën e nevojshme në dhënien e lejeve të ndryshme të shfrytëzimit të burimeve natyrore, do të zbatohet gjerësisht parimi i miratimit në heshtje të shumë prej lejeve, që kërkohen nga biznesi në këtë sektor.

Struktura organizative dhe kompetencat e ERE-s janë të ngjashme dhe me ato të institucioneve rregullatore homologe të vendeve të rajonit dhe më gjërë, si dhe me direktivat e Bashkimit Europian për këtë sektor. Gjithsesi, vlen të theksohet nevoja për plotësimin dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të ERE-s, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisive, që janë gjithmonë në rritje. Kjo, duke patur parasysh zhvillimeve në sektorin e energjisë, konkretisht në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror, forcimit të rolit të rregullatorit në drejtim të monitorimit të të licensuarve, standarteve të shërbimit, që ato ofrojnë, si dhe në kuadër të realizimit të angazhimeve të vendit tonë, me synim final integrimin në Bashkimin Europian.

3.2.2 Organizimi i sistemit elektroenergjetik

Struktura e Sektorit të Energjisë Elektrike

Sikurse është shprehur tek pika 1.8.2, aktualisht sektori publik i energjisë elektrike përbëhet nga tre kompani të ndara sipas funksioneve dhe të pavarura juridikisht dhe financiarisht nga njëra tjetra.

Organizimi i ardhshëm i sektorit të gjenerimit publik

Me ristrukturimin e kompanisë vertikale të integruar KESH, pra ndarjen dhe shkëputjen nga kjo kompani të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), bazuar dhe në Modelin e Ri të Tregut, KESH sh.a. mbeti një strukturë përgjegjëse vetëm për funksionin e prodhimit të energjisë elektrike dhe për funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë.

Bazuar dhe në studimet e bëra nga konsulentë të ndryshëm ndërkombëtarë, organizimi i sektorit të prodhimit të energjisë elektrike mbi bazë kaskade, duket si organizimi më optimal, po të kihet parasysh që operimi i centraleve të një kaskade është i ndërvarur.

Për këtë arsye, gjenerimi publik do të organizohet në shoqëri gjenerimi, të pavarura nga njëra tjetra, të organizuara mbi baza kaskade dhe konkretisht:

1. KESH sh.a., që do të ketë në administrim HEC-et, aktualisht pronë publike në Kaskadën e lumit Drin dhe konkretisht: Hidrocentralet e Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës, si dhe TEC-in Vlorë, nëpërmjet një shoqërie të veçantë për këtë TEC.
2. Sh.a. "Ulëz - Shkopet," që do të ketë në administrim HEC-et, aktualisht pronë publike, në Kaskadën e lumit Mat dhe konkretisht: Hidrocentralet e Ulzës dhe Shkopetit.
3. Sh.a. "Bistrica 1 Bistrica 2", që do të ketë në administrim HEC-et, aktualisht pronë publike, në Kaskadën e lumit Bistricë dhe konkretisht: Hidrocentralet e Bistrica 1 dhe Bistrica 2;
4. Sh.a. Lanabregas, që do të ketë në administrim HEC-in Lanabregas, aktualisht pronë publike;

Në të ardhmen parashikohet, që tre shoqëritë e kaskadave mbi lumenjtë Mat, Bistricë dhe Lanabregas, të privatizohen nëpërmjet shitjes së 100% të aksioneve, kurse Furnizuesi Publik me Shumicë, që sot është pjesë e strukturave të KESH sh.a., të operojë jashtë strukturave të KESH sh.a..

Operatori i Sistemit të Transmetimit (O.S.T. sh.a.) do të vazhdojë të mbetet një kompani publike me pronar shtetin.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Funksionet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik me Pakicë kryen nga CEZ Shpërndarje Sh.a.

Në të ardhmen parashikohet, që Furnizuesi Publik me Pakicë, të ndahet financiarisht nga funksionet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të liberalizohet kjo veprimtari.

Struktura e Sektorit Privat të Energjisë Elektrike

Sektori privat i energjisë elektrike gjatë vitit 2011 është përfaqësuar nga 26 shoqëri private dhe koncesionare për prodhimin e energjisë elektrike, të cilat operojnë në 58 HEC-e me fuqi të instaluar deri 15 MW.

Politika e Qeverisë ndaj këtij sektori ka qenë një politikë nxitëse dhe inkurajuese për zhvillimin sa më efektiv të sektorit privat, me objektiv rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike lokale dhe zhvillimin e punësimit dhe infrastrukturës në zonat më të thella rurale.

Në një periudhë afatmesme parashikohet, që sektori privat të jetë faktor kryesor edhe në prodhimin e energjisë elektrike.

3.2.3 Organizimi i shoqërive publike në sektorin e hidrokarbureve

Aktualisht, në sektorin publik të naftës dhe gazit operojnë shoqëritë publike Albpetrol sh.a, dhe shoqëria Petrol Alba sh.a.

Shoqëria Albpetrol sh.a. vepron kryesisht mbi bazën e marrëveshjeve hidrokarbure, që përbëjnë një formë privatizimi, ndërkohë ,që edhe kjo shoqëri është futur në procesin e privatizimit.

Shoqëria ALBPETROL sh.a., është përfshirë në procesin e privatizimit, i cili është parashikuar që të përfundojë brënda vitit 2012, mbeshtetur në ligjin nr. 10490, datë 15.12.2011, “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol", sha, Patos”, si dhe në ndryshimet që janë bërë në legjislacionin tjetër bazë, për aktivitetin e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve. (ligji nr. 31/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, të ndryshuar”, si dhe ligji nr 32/2012, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)”).

Ndërkohë, që përse i përket sektorit të refinimit, sektori publik zotëron ende 15% të aksioneve në shoqërinë e përpunimit dhe tregtimit të naftës “ARMO” sh.a., aksione të cilat parashikohen, që të kalojnë në privatizim.

3.3 Kuadri ligjor dhe rregullator

Reformat e ndryshme të sektorit energjetik janë të lidhura ngushte dhe me reformën e kuadrit ligjor e nënligjor, prandaj kjo reformë do të vazhdojë të mbetet një çështje prioritare në strategjinë e zhvillimit të këtij sektori.

Pas miratimit të ligjeve baze të sektorit të energjisë, implementimi i kësaj strategjie do të kërkojë plotësimin me kuadrin e plotë nënligjor në zbatim të tyre, në harmoni të plotë me direktivat e Bashkimit Europian, dhe që do të mundësojnë zbatimin e të gjitha detyrimeve ligjore, për një zhvillim të pandërprerë të këtij sektori, me synim sigurimin e burimeve energjetike në mënyrë të vazhdueshme dhe me kostot minimale të mundëshme për konsumatorët shqiptare.

3.3.1 Ligji “Për sektorin e energjisë elektrike”

Zhvillimi dhe rregullimi i sektorit të energjisë elektrike mbështetet në Ligjin nr.9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, që është dhe ligji bazë i këtij sektori.

Ligji është mbështetur në eksperiencën e vendeve më të zhvilluara dhe ka marrë parasysh shumë prej dispozitave të Direktivave të Bashkimit Europian, për tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Ligji përbën një hap të rëndësishëm drejt ristrukturimit të këtij sektori.

Reformat e viteve të fundit në këtë sektor, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian dhe angazhimet që ka ndërmarrë Shqipëria në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe Traktatit të Themelimit të Komunitetit të Energjisë të Europës Juglindore, bënë të nevojshëm rishikimin e disa herë të këtij ligji, në mënyrë ,që të reflektoshin të gjitha këto ndryshime.

Duke patur parasysh ndryshimet, që kanë ndodhur në sektorin e energjisë elektrike, në tregun e energjisë elektrike e integrimin e tij në tregun Rajonal dhe Europian, si dhe amendimet disa herë të këtij ligji, si dhe duke patur në konsideratë, që për energjitë e rinovueshme dhe për efikasitetin e energjisë do të kemi ligje të vecanta, ligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, ju nënshtrua një rishikimi të plotë dhe tashmë kemi një ligj të ri “Për sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me ligjin nr.....datë.....2012.

3.3.3 Ligji për energjitë e rinovueshme dhe hartimi i kuadrit nënligjor të tij

Ligji “Për energjitë e rinovueshme” bazohet në direktivën e Bashkimit Europian 2001/77/EC dhe ka për synim promovimin e burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike.

Ai ka për qëllim të krijojë lehtësira në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe të vendosë në baza preferenciale energjinë e prodhuar nga këto burime. Ai do të mundësojë zvoglimin e pengesave dhe krijimin e hapsirave për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme.

Gjithashtu, në kuadër të energjive të rinovueshme dhe në harmoni dhe me Direktivat e Bashkimit Europian, është miratuar dhe ligji nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport”.

3.3.4 Ligji për efikasitetin e energjisë dhe hartimi i kuadrit nënligjor të tij

Ky ligj është bazuar në Direktivat 2006/32/EC, “Për efikasitetin e energjisë në konsumatorët fundorë dhe shërbimet energjetike”, 2010/31/EU “Për performancën në banesa”,

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor, që kërkohet për hartimin dhe zbatimin e një politike kombëtare për nxitjen dhe përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, përgjatë gjithë ciklit të energjisë, me synimin e rritjes së sigurisë së furnizimit, përmirësimit të konkurrueshmërisë ekonomike të ekonomisë kombëtare, minimizimit të ndikimit negativ në mjedis dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike.

Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar në muajin Mars 2008 nga Qeveria Shqiptare, është Dokumenti bazë që rregullon marrëdhëniet në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri.

Ky Model është i ndërtuar në bazë të konsideratës, që Qeveria Shqiptare është garante e sigurimit të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.

Modeli i Tregut përshkruan detyrat dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike, karakterizohet nga kontrata bilaterale të energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

Në këtë Model, përveç funksioneve të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes, trajtohen dhe funksionet e Furnizuesit Publik me Shumicë dhe të Furnizuesit Publik me Pakicë.

Ky model i ndan funksionet e furnizimit në furnizimin me shumicë dhe në furnizimin me pakicë.

Furnizuesi Publik me Shumicë përfshihet brënda KESH sh.a. dhe është përgjegjës për të blerë energji elektrike nga tregu i rregulluar dhe ai i hapur, bazuar në parashikimin e kërkesës për energji elektrike të Konsumatorëve Tariforë, të përgatitur nga Furnizuesi Publik me Pakicë, dhe për ta shitur atë tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (Furnizuesi Publik me Pakicë), me çmime të rregulluara.

Furnizuesi Publik me Pakicë është një strukturë, që përfshihet brënda Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe është përgjegjës për të blerë energjinë elektrike me çmime të rregulluara, nga Furnizuesi Publik me Shumicë, dhe për ta shitur atë tek klientët tariforë.

Gjithashtu, Furnizuesi Publik me Pakicë është përgjegjës për të blerë energjinë elektrike me çmim tregu, për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike, u shoqërua edhe me përpunimin e shumë prej akteve rregullatore të miratuara nga ERE në zbatim të tij, si Rregullat e Tregut, Kodet e Transmetimit, Shpërndarjes dhe Matjes, Procedurat e Liçensimit etj..

Struktura e tregut të brëndshëm

Struktura kryesore e tregut të brëndshëm është shënjuese e Kontratave Bilaterale but, ndërkohë sygjerohet, që Shqipëria të marrë pjesë gjithashtu në tregun rajonal, ku Shkëmbimi Rajonal Energjistik, duke u vendosur. Kështu, për të paktën 5 vjetët e ardhshme, në Shqipëri tregu do të jetë një kombinim mes tregut bilateral kombëtar dhe shkëmbimit rajonal energjistik.

Modeli autorizon OSSH-në të blejë energjinë elektrike, që duhet për të mbuluar humbjet me anë të importit, me çmim të parregulluar, në përpjekje, për të stimuluar uljen e humbjeve. Brënda OSSH-së, Furnizuesi Publik me Pakicë blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumicë dhe e shet atë tek konsumatorët tariforë me çmim të rregulluar, të miratuar nga ERE. Bazuar në Modelin, prioritet i jepet prodhimit vendas të energjisë elektrike nga Hec-et, që të plotësohen në rradhë të parë nevoja e konsumatorëve tariforë.

Modeli përmban edhe specifika, që synojnë mbrojtjen e Konsumatorëve Tariforë, ndërsa tregu hapet gradualisht ndaj konkurrencës. Tregu i rregulluar do të lejojë furnizimin e Konsumatorëve Tariforë me një tarifë të aprovuar nga ERE.

Synohet në uljen e pragut kualifikues të kalimit nga konsumator tarifor në Klientë të Kualifikuar, në mënyrë, që brënda datës 1 Janar 2015, përcaktuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, të kemi një treg plotësisht të liberalizuar.

Përputhja me rregullat si dhe monitorimi i tregut të energjisë mbeten përgjegjësi të ERE.

3.3.2 Legjislacioni i sektorit të hidrokarbureve

Zhvillimi dhe rregullimi i sektorit energjetik hidrokarbur mbështetet në dy ligje kryesore, Ligji nr.7746, datë 28.07.1993, "Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", si dhe ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar. Për këtë sektor ekzistojnë edhe një sërë aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore specifike, që rregullojnë aspekte të vecanta të veprimtarisë, lidhur me politikat fiskale, normat teknike dhe standardet për impiantet dhe instalimet në sektorin hidrokarbur, rregullimin e marrëdhënieve, për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës përkatëse, etj.

Në vitin 2008 u miratua ligji për sektorin e gazit natyror (Ligji nr. 9946, datë 30.06.2008), që është mbështetur në legjislacionin e Bashkimit Europian. Përdorimi i këtij burimi energjetik në ekonominë shqiptare, jo vetëm për prodhimin e energjisë elektrike, por dhe në industri, duket të jetë i afërt. Për plotësimin e kuadrit ligjor është duke u punuar për aktet nënligjore, të cilat duhet të kenë parasysh direktivat e BE-së, siç janë: Direktiva 91/29/EC (Mbi transportin e gazit natyror nëpër rrjetet tranzit), Direktiva 90/337/ËC (Mbi transparencën e çmimeve) dhe Direktiva 2003/55/EC ("Direktiva e gazit").

Ligji nr. 10490, datë 15.12.2011, "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a, Patos", si dhe ndryshimet, që janë bërë në legjislacionin tjetër bazë, për aktivitetin e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve: ligji nr. 31/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", të ndryshuar", si dhe ligji nr 32/2012, "Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)"".

3.4 Energjia elektrike

3.4.1 Optimizimi i Sistemit të Furnizimit dhe Rritja e Sigurisë së Furnizimit me Burime Energjetike

Mundësitë e Operimit të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar

Nga investigimi i një tërësi mundësish, për plotësimin e nevojave për energji elektrike në tregun e vendit tonë, ndër të tjera, janë realizuar dhe këto analiza ndjeshmërie:

1. Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar i konsideruar i izoluar dhe që vetëplotëson nevojat e tij;
2. Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar i konsideruar si një sistem që ndërvepron me vendet e rajonit;
3. Optimizimi i Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar me Sistemin Elektroenergjetik Kosovar

Në analizën e parë, në zgjedhjen e centraleve të reja që do të mbulojnë ngarkesën, janë marrë në konsideratë çmimet ndërkombëtare të lëndëve djegëse të diezel marinës, gazit natyror, si dhe tendencat e tyre në tregun ndërkombëtar. Gjithashtu, në analizë janë marrë në konsideratë edhe investimet fillestare, kostot e operimit dhe shfrytëzimit dhe së bashku me koston e lëndëve djegëse, janë llogaritur kostot për njësi të gjenerimit të energjisë elektrike për secilën teknologji dhe për secilën lëndë djegëse për TEC-et, duke përfshirë edhe ata me qymyr importi. TEC-et me qymyr importi janë konsideruar, për shkak të mungesës së plotë të lëndëve djegëse në vend dhe për shkak të rezervave të kufizuara të hidrokarbureve në nivel global.

E njëjta procedure është ndjekur edhe për vlerësimin e kostos njësi për HEC-et.

Gjithashtu, shtimi i kapaciteteve të tjera termike, sidomos me lidhjen e Shqipërisë me rrjetin rajonal të gazit, do të bëjë të mundur shfrytëzimin me efikasitet të HEC-eve, për të punuar në ngarkesë mesatare dhe në pik, për të plotësuar grafikun ditor dhe vjetor të nevojave për energji elektrike. Kjo mënyrë operimi do të sjellë një ndikim pozitiv në përbalimin e ngarkesës dhe një shfrytëzim ekonomik të burimeve.

Në analizën e dytë, për periudhën deri në 5 vjet, duke patur parasysh kohën e nevojshme për ndërtimin e centraleve të reja të dhëna me koncesion, është marrë në konsideratë plotësimi i nevojave aktuale dhe atyre shtesë edhe nëpërmjet rritjes së importit. Megjithatë, duhet theksuar se, pavarësisht nga kjo analizë, Skenari udhëzon që, duke pasur parasysh pasiguritë në lidhje me gjetjen dhe transmetimin në rajon të sasive të nevojshme të importit, si dhe përkeqësimin e kushteve hidrologjike të vendit, del detyrë e domosdoshme, të parashikohet shtimi i kapaciteteve gjeneruese, për të rritur sigurinë e furnizimit dhe për të ulur varësinë nga importi.

Rekomandohet, që në terma afat shkurtër, të planifikohet një nivel i caktuar i energjisë elektrike, që do të importohet, që do të shërbejë, për të mbuluar bazën e grafikut të ngarkesës së bashku me vënien në punë të TEC-it të Vlorës CCGT (97 MW) dhe të një impianti tjetër termik.

Në analizën e tretë, shqyrtohet mundësia e optimizimit të përbashkët të dy sistemeve, atij Shqiptar dhe Kosovar. Ky opsion mundëson funksionimin e dy sistemeve në mënyrë të optimizuar, si nga pikëpamja e ngarkesave që ato do të mbulojnë, ashtu dhe nga pikëpamja e efekteve financiare dhe çon në reduktimin e kostos së gjenerimit, për shkak të reduktimit të kostos së lëndës djegëse, që do të jetë qymyri linjit i Kosovës.

Në këto kushte, është e rëndësishme ndërmarrja e një studimi të plotë lidhur me zgjedhjen e mënyrës më të përshtatshme të optimizimit të dy sistemeve.

Bashkëpunimi ka filluar me shkëmbime të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke shfrytëzuar kapacitetet ekzistuese të dy sistemeve dhe natyrën komplementare të tyre, duke eksportuar në pik (drejt Kosovës) dhe importuar në bazë (nga TEC-et e Kosovës).

Hap shumë i rëndësishëm, në realizimin e këtij opsioni, është fillimi i ndërtimit të linjës 400 kV të interkoneksionit Tiranë-Prishtin.

Mundësitë më të mëdha janë që sistemi elektroenergjetik shqiptar të zhvillohet sipas opsionit të dytë dhe me perspektivë drejt opsionit të tretë.

Mbështetur në objektivat e Qeverisë, për një zhvillim të ekonomisë së vendit dhe të rritjes së komoditetit të qytetarëve shqiptarë, dhe në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, diversifikimin e burimeve energjetike dhe respektimin e standarteve mjedisore, është llogaritur kërkesa për energji elektrike. Vlerësimet, për mbulimin e kësaj kërkesë, bazohen në programe të investimeve mbi bazën e kostos më të ulët. Në këtë mënyrë, janë identifikuar kapacitetet e reja të HEC-eve dhe TEC-eve, që duhen ndërtuar, si dhe sasitë e energjisë elektrike, që duhet importuar.

Por, analizat e mësipërme bazohen në burime të reja gjeneruese, që duhet të ndërtohen patjetër, në Shqipëri dhe, që presupozojnë projekte të kërkuara nga Qeveria Shqiptare.

Nga ana tjetër, ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pra zgjidhjen e furnizimit me energji elektrike dhe krijimin e tepricave për eksport, ne e shohim në tërheqjen e investitorëve privatë, pra tek investimet private, të cilat, në rastin e kaskadave, marrin parasysh jo thjesht identifikimin e optimizimit të një HEC-i, por maksimalizimin e integruar të shfrytëzimit të HEC-eve të një lumi.

Për këtë arsye, Politika e Qeverisë Shqiptare për ndërtimin e objekteve gjeneruese mbështetet në dhënien me koncension të tyre, duke u bazuar në marrëdhëniet e partneritetit privat-publik për rastin e HEC-eve. Kështu është vepruar për ndërtimin e HEC-it të Ashtës, kaskadën e lumit Devoll dhe kështu po procedohet edhe për ndërtimin e HEC-it të Skavicës, si dhe për HEC-et e tjera, që do të ndërtohen mbi lumin Vjosë e Osum.

Nga ana tjetër, për tërheqjen e investimeve private, për ndërtimin e burimeve të reja të energjisë elektrike, që nuk i nënshtrohen ligjit të koncesionit, si të centraleve termike, atyre të erës, të biomasës etj., ka një kuadër tjetër ligjor dhe mbi këtë kuadër, tashmë janë firmosur kontrata për parqe eolike e biomase, si dhe po shqyrtohen projekt-propozime për ndërtim TEC-esh.

Më poshtë po paraqesim veprat e reja gjeneruese, që duhet të ndërtohen, për të përballuar kërkesën, deri në vitin 2020:

■		
•	Hydrocentrale të vegjël	444 MW
•	HEC-i Devolli1	75 MW
•	HEC-i Vjosa1	93 MW
•	HEC-i Drini1	48 MW
•	TEC-i i Vlorës	97 MW
•	TEC-e të Rinj	300 MW

Duke patur parasysh politikën prioritare të ndjekur deri tani në rehabilitimin e HEC-eve ekzistuese dhe tashmë të realizuar nga pikpamja mekanike, elektrike dhe e komandimit, gjatë periudhës 2013-2016 do të vazhdojë puna për realizimin e Projektit “Për sigurinë e digave”.

Në zbatim të studimit të fizibilitetit “Për sigurinë e digave”, i cili do të rrisë sigurinë e punës të hidrocentraleve të kaskadës së Drinit dhe Matit, është nënshkruar marrëveshja financiare me Bankën Botërore (IDA), dhe parashikohen bashkëfinancime dhe nga EBRD, KfW dhe Qeveria Zviceriane, për realizimin e plotë të këtij projekti.

Energjia bërthamore si burim alternativ

Opsioni i energjisë bërthamore vlerësohet si një alternativë e rëndësishme, për të rritur sigurinë e furnizimit dhe plotësimin e nevojave të ardhshme për energji, me kosto të ulët dhe të pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Skenari Referues nuk e përjashton këtë alternative si mundësi, që të parashikohet pas vitit 2020.

3.4.2 Masterplani i zgjerimit të Rrjetit të Transmetimit për energjinë elektrike për periudhën 2013-2020.

Masterplani i zhvillimit të rrjetit transmetues është përgatitur në mënyrë, që të mbulojë nevojat e transmetimit të energjisë elektrike me një kosto minimale, me një shërbim cilësor të mjaftueshëm dhe në përputhje me kriteret e planifikimit dhe të sigurisë së punës të sistemit.

Mbështetur në kushtet e mësipërme janë marrë në konsideratë të gjithë përforcimet e rrjetit, që rezultojnë me përfitime ekonomike dhe që plotësojnë kërkesat teknike, për një operim të sigurt të sistemit transmetues të integruar me sistemin e ENTSO-së.

Sistemi i transmetimit, i propozuar sipas masterplanit përkatës, parashikohet të arrijë objektivin e humbjeve vjetore prej 2% në vitin 2020.

Bazuar në rekomandimet e Masterplanit të Sistemit të Gjenerimit dhe të Transmetimit, po realizohen projektet e mëposhtëme:

- Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Dispeçer, që parashikohet të komisionohet në vitin 2013;
- Ndërtimi i Linjës së interkoneksionit 400kV Tiranë (Kashar), - Prishtinë, që parashikohet të komisionohet në vitin 2014;

Kurse projektet prioritare për të ardhmen janë:

- Linja 220 kV Tirana2-Rrashbull
- Linja 220 kV Elbasan-Fier
- Unaza 110 kV e Tiranës
- Linja 110 kV Korçë-Kolonjë-Përmet-Tepelenë-Memaliaj- Ballsh.
- Linja 110 kV Vlorë-Himarë-Sarandë
- Linja 110 kV Vau Dejës-Velipojë
- Linja 110 kV Fierzë-Kukës.
- Linja 400 kV Maqedoni-Shqipëri

Me shumë interes janë paraqitur disa projekte interkoneksioni elektrik nënujor Shqipëri –Itali si:

- Vlorë-Itali, parashikohet të komisionohet në vitin 2015;
- Vlorë-Itali, parashikohet të komisionohet në vitin 2015

3.4.3 Masterplani i rehabilitimit të sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2013-2020

Bazuar në strategjinë e furnizimit të sigurtë dhe të reduktimit të humbjeve teknike, masterplani i sistemit të shpërndarjes synon në identifikimin dhe vlerësimin e opsioneve më të mira, për shtrirjen e rrjetit, në mënyrë, që ai të arrijë të plotësojë nevojat në rritje, për të gjithë kategoritë e konsumatorëve dhe në përdorimin eficient të energjisë elektrike. Masterplani i shpërndarjes është hartuar për çdo rajon dhe gjithashtu janë parashikuar edhe rrjetat për çdo rreth. Plani i rehabilitimit dhe zgjerimit është realizuar rast pas rasti, duke analizuar ndërhyrjet e kërkuara për rritjen e sigurisë së furnizimit, reduktimin e humbjeve teknike dhe plotësimin e nevojave deri në vitin 2020.

Në strategjinë e zhvillimit për sektorin e shpërndarjes parashikohet:

- Ulja e humbjeve të energjisë elektrike deri në nivelin 15%
- Zhvillimi i rrjetit shpërndarës, për të garantuar një furnizim të pandërprerë të konsumatorëve me energji elektrike
- Zhvillimi i rrjetit shpërndarës për të garantuar një furnizim të konsumatorëve me energji elektrike brënda parametrave teknike;
- Zhvillimi me përparësi i rrjetit shpërndarës për zonat urbane me zhvillim të shpejtë;
- Zhvillimi me përparësi i rrjetit në zonat turistike;

Për realizimin e këtyre objektivave, do të realizohen investime në masën rreth 100 milion Euro, ku objektet më të rëndësishme janë ato ku ndërtohen dhe linjat 110 kV dhe konkretisht:

- Ndërtimi apo fuqizimi i nënstacioneve dhe i rrjetit përkatës shpërndarës në zonën Korçë-Kolonjë-Përmet-Tepelenë-Memaliaj- Ballsh.
- Ndërtimi apo fuqizimi i nënstacioneve dhe i rrjetit përkatës shpërndarës në zonën Vlorë-Himarë-Sarandë
- Ndërtimi apo fuqizimi i nënstacioneve dhe i rrjetit përkatës shpërndarës në zonën e Velipojës

Ky program është e kuptueshme, që do të realizohet nga operatori privat, i cili ka një program ambicioz investimesh për periudhën e parë pesëvjeçare.

3.4.4 Humbjet teknike

Humbjet e energjisë elektrike, teknike dhe jo teknike, përfaqësojnë sfidën më të vështirë dhe me efektin më të rëndë negativ në veprimtarinë ekonomiko-financiare të OSSH-së.

Humbjet teknike, të cilat kanë një vlerë shumë të lartë, prej rreth 18%, në shpërndarje, varen drejtpërsëdrejti nga niveli jo i mirë teknik dhe mosplotësimi i kushteve dhe standarteve teknike të sistemit të shpërndarjes. Përmirësimi i tyre lidhet me investime të konsiderueshme për rehabilitimin e sistemit elektrik të transmetimit e të shpërndarjes, të cilat u përmendën më sipër.

Për periudhën pesëvjeçare 2010-2014, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i privatizuar, ka një skedul të përcaktuar për zvoglimin e humbjeve teknike dhe joteknike, të shprehur në Deklaratën Rregullatore. Kështu, për dy vitet e para, ai duhet të ulë humbjet me 4 % në vit, dhe për tre vitet e tjera, këto humbje duhet të zvogëlohen në total me 9 %.

Kurse Operatori i Sistemit të Transmetimit do të ulë humbjet në rrejt nga 4 % në 2%.

3.5 Ecuria e Tarifave të Energjisë Elektrike deri në vitin 2020

Qeveria Shqiptare në objektivat e saj ka edhe shndërrimin e sistemit elektroenergjetik në një sistem eficient, të aftë dhe konkurrues, për të operuar në tregun e brëndshëm dhe jashtë tij. Për këtë qëllim, krahas reformave dhe masave të ndryshme, që janë ndërmarrë deri tani dhe të atyre që parashikohen të ndërmerren edhe në të ardhmen, parashikon të realizojë edhe një çmim sa më të ulët të energjisë elektrike tek konsumatori final.


Reforma tarifore konsiderohet si një hap i domosdoshëm, por dhe shumë delikat, sepse nga njëra anë duhet të forcohet situata ekonomiko-financiare dhe teknike e shoqërive, që veprojnë në sektorin energjetik, por nga ana tjetër, duhet patur në konsideratë dhe mundësia për të përballuar pagesën nga konsumatori shqiptar dhe mbrojtjen e shtresave të ndryshme sociale nga impakti i rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

ERE ka përcaktuar çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike dhe të shërbimeve në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes për vitin 2012, bazuar në metodologjitë përkatëse të llogaritjes së tyre,


sipas parimeve të mbulimit të kostove të shërbimit, që shkaktohen nga çdo grup klientesh në çdo nivel tensioni, ku ofrohen shërbimet e energjisë elektrike. Në këtë mënyrë jepen sinjalet e duhura, për përdorimin me efikasitet të energjisë elektrike, nga klientët tariforë dhe njëkohësisht eliminohen ndërshtetërisht ndërmjet grupeve të klienteve, me qëllim, që shoqëritë të sigurojnë vazhdimësinë e aktivitetit, duke realizuar një normë të arsyeshme fitimi. Tarifat dhe çmimet e vendosura i janë nënshtruar një procesi transparent dhe të drejtë me të gjitha grupet e interesit në çdo rast të rishikimit të tyre.

Tarifat dhe çmimet e vendosura kanë tentuar të sigurojnë nxitjen e investimeve në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike, për të garantuar në të ardhmen një furnizim të sigurtë dhe të qëndrueshëm me energji elektrike.

Në grafikët e mëposhtëm jepet ecuria e tarifave sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë të vitit 2003 dhe sipas parashikimeve të kësaj strategjie.



Grafiku. 11: Tarifat e energjisë elektrike sipas strategjisë të vitit 2003 [cent/kWh]



Grafiku. 12: Tarifat e energjisë elektrike në strategjinë 2013-2020 [cent/kWh]

Në analizën e bërë, në seksionet e Masterplaneve të Gjenerimit, Transmetimit dhe Shpërndarjes, janë vlerësuar investimet e nevojshme për të zbatuar këto masterplane, të kombinuara me rritjen e efikasitetit në sektorin elektroenergjetik.

Në Strategjinë e paraqitur, është trajtuar ecuria e tarifave të energjisë elektrike, duke u bazuar në parimin që tarifat e aplikuar në periudha të caktuara të mbulojnë kostot e prodhimit, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Tarifat duhet të jenë të mbështetura në koston e shërbimit (*break-even*), nëpërmjet të cilës të sigurohen të ardhurat e nevojshme, për të mbuluar të gjitha kostot e krijuara dhe gjithashtu, të realizohet një normë e caktuar fitimi.

Studimi i tarifave të energjisë elektrike deri në fund të periudhës studimore; bazohet në investimet kapitale, që duhet të realizohen në gjenerim, transmetim dhe shpërndarje, në kostot fikse dhe variabël të operimit dhe të mirëmbajtjes, në kostot e lëndëve djegëse dhe kostot e importeve. Përfshirja e tyre është baza e llogaritjes së kostos, njësi afatgjatë marxhinale.

Analiza tregon, që niveli i kostos marxhinale afatgjatë në vitin 2020 do të jetë në nivelin e rreth 16 eurocent/kWh. Në strategjinë e mëparshme kostoja afatgjatë marxhinale ishte llogaritur në nivelin e 12 eurocent/kWh. Ky ndryshim midis dy strategjive ka ardhur si rezultat i ndryshimit në rritje të çmimeve të pajisjeve teknologjike në tregun botëror, rritjes së çmimeve të importit të energjisë, si dhe rritjes së çmimeve të lëndëve djegëse.

3.6 Hidrokarburet

3.6.1 Infrastruktura e importit dhe e stokimit të hidrokarbureve

Infrastruktura e tregut të nënprodukteve të naftës (karburanteve dhe lëndëve djegëse) paraqitet e shpërndarë në të gjithë territorin e vëndit, ku ndodhen impiante me kapacitete të konsiderueshme për depozitimin e këtyre produkteve, të cilat zotërohen nga shoqëri të ndryshme, që janë licencuar për të kryer aktivitetet të tregtimit me shumicë. Këto shoqëri administrojnë dhe kanë në përdorim edhe një numër shumë të konsiderueshëm të stacioneve të shitjes me pakicë të karburanteve dhe lëndëve djegëse. Në të ardhmen parashikohet, që si rezultat i zhvillimit konkurrues dhe rritjes së efikasitetit në këtë treg, do të ketë një optimizim të këtyre stacioneve në të gjithë territorin e Shqipërisë, bazuar në normat dhe standartet Europiane.

Skenari E&RE, merr në konsideratë dhe vlerëson zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së import-eksportit dhe të depozitave bregdetare të përqëndruara në dy zona,

- në Gjirin e Vlorës, ku është në funksionim, që nga viti 2009, porti i naftës “Vlora-1” dhe terminali bregdetar i naftës, të cilat administrohen nga shoqëria koncesionare “La Petrolifera Italo Albaneze” sh.a.
- në Zonën Energjetike dhe Industriale të Porto Romanos Durrës, ku është në funksionim, që nga viti 2009, porti i naftës i “Porto-Romanos” i cili administrohet nga shoqëria koncesionare “Romano Port” sh.a. dhe terminali bregdetar i naftës, në të cilin depoziat janë ndërtuar dhe administrohen nga shoqëri të ndryshme.

Ndërtimi i këtyre terminaleve është në përputhje të plotë me normat dhe standartet teknike Europiane, po kështu është duke u zhvilluar edhe infrastruktura lidhëse për këto terminale, e cila do të mundësojë, që këto terminale të shërbejnë jo vetëm për tregun e brëndëshëm, por dhe për vëndet fqinje.

Për të arritur normat e direktivave e Bashkimit European, në legjislacionin ekzistues janë bërë ndryshime, duke rritur sasinë e rezervës së sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj, e cila aktualisht është sa për 90 ditë mesatare shitjeje.

3.6.2 Prodhimi i naftës dhe gazit deri në vitin 2020

Prodhimi i naftës nga vendburimet ekzistuese është i mbështetur në tre variante, të cilët kanë ecuri të ndryshme të prodhimit: ecuri normale, mbi normale dhe maksimale të prodhimit, bazuar në teknologjitë e shfrytëzimit të vendburimeve.

Strategjia Kombëtare e Energjisë parashikon një ecuri normale të rritjes të prodhimit të naftës nga vitet 2013-2015, me një maksimum deri në 1100 ktoe në vit, më tej do të fillojë rënia e prodhimit për të arritur në 900 Ktoe në vitin 2015 dhe 600 Ktoe në vitin 2020. Në analizën e burimeve të rinovueshme, kjo alternativë do të merret në konsideratë, pasi ruan një ecuri normale të shfrytëzimit të vendburimeve.

Prodhimi i Gazit është parashikuar në një nivel minimal, bazuar në shfrytëzimin e vendburimeve ekzistuese të gazit natyror dhe të naftës. Realizmi i investimeve të programuara në vendburimin e gazit-kondesat të Delvinës nga ana e kompanisë, që po e operon këtë vendburim në kuader të Marrëveshjes Hidrokarbure, parashikohet, që të rrisë prodhimin e gazit deri në 6 herë (në rreth 60 mijë m³ në ditë), gjë e cila do të mbështesë edhe investime të mëtejshme në këtë vendburim.

Në Skenarin i Burimeve të Rinovueshme dhe Eficencës së energjisë merret në konsideratë edhe mundësia e zbulimit të vendburimeve të reja të naftës dhe gazit, si rezultat i shpimeve të reja të puseve të kërkimit në blloqet e kërkimit në tokë dhe në det, që janë dhënë me Marrëveshje Hidrokarbure. Vlerësohet, se Shqipëria ka ende të pazbuluar rezerva të konsiderueshme hidrokarburesh.

3.6.3 Lidhja e Shqipërisë me Rrjetet Ndërkombëtare të Naftës dhe Gazit

Shqipëria nuk është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare të naftës dhe gazit natyror dhe aktualisht, është studiuar mundësia, për lidhjen e saj me këto rrjete. Skenari i burimeve të rinovueshme mbështet të gjitha opsionet, që e përfshijnë vendin tonë në rrjetin ndërkombëtar të naftës dhe të gazit, duke i dhënë prioritet projektit, që e konsideron Shqipërinë si një vend tranziti dhe merr në konsideratë dhe përparësitë, që ofron vendi ynë, për mundësitë e stokimit nëntokësor të gazit.

Ndër projektet, të cilat mund të kenë zhvillim të mundshëm për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit, si dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të gazit, janë:

- Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (Trans Adriatik Pipeline - TAP), që po zhvillohet nga konsorciumi TAP AG, me aksionere kompaninë norvegjeze Statoil 42,5%, kompaninë zviceriane EGL 42,5% dhe kompaninë gjermane E-on Rhurgaz 15%. Ky gazsjellës do të jetë pjesë e një koridorri të ri të furnizimit me gaz të Europës, "Koridori Jugor i Gazit", që do të sjellë në Europë gazin e vendeve të Kaspikut dhe të Lindjes së Mesme. Gazsjellësi me një gjatësi rreth 800km dhe kapacitet transportimi 10 bcm (me mundësi rritjeje deri në 20 bcm), do të kalojë nga territori grek në territorin e vendit tonë dhe nga bregdeti i Semanit (Deti Adriatik) do të arrijë në bregdetin e Italisë së Jugut.

Vendi ynë e ka mbështetur këtë alternativë dhe ka rritur bashkëpunimin me kompaninë TAP AG, duke kaluar në fazën e negociimit të Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet tre vendeve (Itali, Shqipëri dhe Greqi), si dhe të Marrëveshjes, që Shqipëria do të realizojë me kompaninë TAP AG. Aktualisht, ERE po shqyrton aplikimin e paraqitur nga kompania TAP AG, për dhënien e miratimit, për përjashtim nga aksesit i palës së tretë, si dhe po bashkëpunon në këtë drejtim me entet rregullatore të dy vendeve të tjera. Shqipëria shfrytëzon pjesmarrjen në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, që mbështet projektet e gazit, të cilat krahas furnizimit të vendeve të BE, realizojnë gazifikimin e sa më shumë vendeve të Europës Jug-Lindore.

- Projekti i Gazsjellësit Jonian Adriatik (Ionian Adriatik Pipeline - IAP). Projekti ka të bëjë me planet e zhvillimit të rrjetit të gazit natyror të Ballkanit Perëndimor, nga Kroacia drejt Bosnjës & Hercegovinës, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ky projekt parashikohet të funksionojë në sistem unazor, ku furnizimi do të kryhet në dy drejtime, nga veriu me sistemin Kroat dhe nga jugu gazsjellësi i projektit TAP. Projekti IAP do të jetë njëkohësisht pjesë e Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë (Energy Community Gas Ring), që është një projekt rajonal, i miratuar nga Komuniteti i Energjisë dhe BE. Projekti i gazsjellësit IAP, aktualisht është në fazën e realizimit të studimit të fizibilitetit, me një financim 3 milionë EURO nga BE.

3.7 Nxitja e Përdorimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë

Zhvillimi i burimeve të rinovueshme është një nga objektivat e parashikuara për plotësimin e kërkesës për energji elektrike dhe termike, në kuadër të përdorimit të energjive të pastra.

Në kuadër të detyrimeve, që rrjedhin nga nënshkrimi i Traktatit të Themelimit të Komunitetit të Energjisë në vitin 2005, dhe të nismës 20/20/20 të Bashkimit Europian, sipas të cilës deri në vitin 2020 duhet të rritet me 20% përdorimi i energjive të rinovueshme, të rritet me 20% eficaenca e energjisë dhe të ulet me 20% emetimi i CO₂ në atmosferë. Shqipëria, deri në vitin 2020 do të rrisë me 39% përdorimin e energjive të rinovueshme.

Për realizimin e këtij objektiivi është hartuar dhe Plani Kombëtar i Veprimit të Energjive të Rinovueshme, që përcakton të gjitha veprimet, që duhet të ndërmerren, strukturat përgjegjëse, kostot e ndërhyrjeve, si dhe afatet konkrete.

Ndër detyrat kryesore, që parashikohen në këtë Plan Veprimi përmendim:

- Shfrytëzimin e energjisë hidrike nga HEC-et e vegjël.
- Ndërtimin e impianteve të vegjël koogjenerues.
- Ndërtimin e impianteve të sistemeve të paneleve diellore.
- Shfrytëzimin e energjisë së erës.
- Shfrytëzimi i biomasës, etj.

Për realizimin e këtij treguesi, Qeveria Shqiptare, duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nxitjes së përdorimit të burimeve të rinovueshme nëpërmjet hartimit dhe vënies në zbatim të politikave dhe instrumentave, që e nxisin përdorimin e tyre.

Kjo duhet të realizohet nëpërmjet përcaktimit të saktë të politikave incentivuese, sidomos atyre fiskale, që çojnë në rritjen e shfrytëzimit të këtyre burimeve.

Zbatimi i këtyre politikave do të mundësojnë kapërcimin e disa pengesave që lidhen me:

- Mungesën e kuadrit të plotë nënligjor në këtë fushë;
- Koston e lartë të prodhimit të energjisë elektrike nga këto burime;
- Mungesën e tregut të certifikatave të origjinës dhe të tregtimit të krediteve të energjive të pastra.

Përdorimi në të ardhmen i Certifikatave të Origjinës dhe Mekanizmave të Zhvillimit të Pastër (CDM) për vendin tonë, do të shërbejnë si instrumente për thithjen e investimeve të huaja, transferime teknologjish dhe njohurish për ndërtimin e impianteve, që gjenerojnë energji eficiente dhe të pastër, duke kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm të sistemit energjetik dhe të ekonomisë së vendit, me sa më pak emetime të ndotësve në atmosferë.

3.8 Nxitja e Përdorimit Efiçent të Energjisë

Për nxitjen e përdorimit efiçent të energjisë është miratuar ligji nr. date.....2012, “Per eficencën e energjisë”, dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. , date 9.9.2011 është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për rritjen e Eficencës së Energjisë”

Në Nenin 4, të Direktivës 2006/32/EC është përcaktuar se Vendet Nënshkruese të Komunitetit të Energjisë do të miratojnë masat, me qëllim, që të arrijnë treguesin për rritjen 9% të treguesit të efiçencës së energjisë për 9 vitet e ardhshëm.

Gjatë hartimit të këtij Plani Veprimi është patur në konsideratë detyrimi i mësipërm, si dhe tre direktivat e Bashkimit Europian dhe respektivisht: direktiva 2006/32/EC “Mbi përdorimin me efiçencë të energjisë për përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike”, direktiva 2002/91/EC “Performanca energjetike në ndërtesa” (amenduar me 2010/31/EP) dhe direktiva 92/75/EC (amenduar me direktivën e 2010/30/EP).

PKVEE është ndërtuar duke u mbështetur në disa elementë të rëndësishëm, si ecuria në vite e konsumit të burimeve energjetike, potencialet për kursimin e energjisë në degët e ekonomisë, mundësia e financimit të investimeve për përmirësimin e efiçencës së energjisë, përmirësimet dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, institucionet/strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e procesit të implementimit të masave, për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë, etj.

PKVEE parashikon një paketë masash efiçente, për t'u zbatuar në sektorët e: Banesave, Shërbimeve, Industrisë, Transportit dhe vlerësime për kursimin e energjisë në sektorin e bujqësisë.

Zbatimi i PKVEE-së së parë në Shqipëri, aktualisht është edhe faza fillestare e implementimit të politikës kombëtare për efiçencën e energjisë.

Për kapjen e treguesit prej 9% deri në vitin 2018, është parashikuar edhe një objektiv i ndërmjetëm i

kursimit të energjisë, që do të jetë sa 3% e konsumit mesatar të periudhës tre-vjecare të referuar (pa marrë në konsideratë konsumin e transportit ajror).

Treguesit e plotësimit të objektivave janë shpërndarë në sektorët e konsumit final të energjisë, prandaj edhe efektiviteti i masave të propozuara kërkon monitorim në mënyrë specifike sipas sektorëve.

Norma kombëtare treguese vjetore e kursimit të energjisë në vitin 2018 do të jetë 160 Ktoe

Norma kombëtare treguese vjetore e ndërmjetme e kursimit të energjisë në vitin 2012 do të jetë 26 Ktoe;

Këto norma kursimi të energjisë janë ndarë sipas sektorëve të përmendur më sipër.

Për zbatimin e PKVË, do të jetë shumë e rëndësishme nevoja e harmonizimit të kuadrit tonë përkatës ligjor dhe nënligjor me direktivat e BE. Për hartimin e kuadrit nënligjor po punohet dhe plotësimi i tij do të përfundojë brenda vitit 2013.

Por si shumë e rëndësishme duhet të konsiderohet, sidomos, zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Mbulimi i investimeve për rritjen e efikasitetit të energjisë do të bëhet nga fondet publike dhe fondet e investitorëve privatë.

Në total, për të gjithë sektorët e analizuar, vlera e fondeve publike të nevojshme për t'u investuar, në funksion të zbatimit të masave të efikasitetit, mund të arrijë afërsisht në vlerën 6,687,000 euro.

Të ndara sipas sektorëve ato janë:

Sektori i banesave	1,170,000	Euro
Shërbimet	1,317,000	Euro
Industria	2,100,000	Euro
Transporti	2,100,000	Euro
Totali	6,687,000	Euro

Është konsideruar, që fondet publike, për zbatimin e masave të Eficencës së Energjisë, do të sigurohen nga burime të tilla si: kredi nga bankat; projekte me bashkëfinancim, buxheti i shtetit, akorduar institucioneve në varësi, krijimi dhe përdorimi i Fondit të Eficencës, fonde nga donatorë ndërkombëtarë, donatorë të tjerë, etj.

Zbatimi i PKVË do të sjellë:

- Reduktimin e konsumit të lëndëve energjetike
- Rritjen e sigurisë së furnizimit
- Reduktimin e emetimeve në atmosferë
- Rritjen e të ardhurave reale për popullsinë
- Përmirësimin e intensitetit energjetik dhe rritjen e komfortit të jetesës
- Një mënyrë të re, të sjelljes së konsumatorëve, përkundrejt përdorimit të burimeve të energjisë.

3.9 Hapja e Tregut të Energjisë

3.9.1 Hapja e tregut të energjisë elektrike

Vendi ynë aspirojnë t'i bashkohet vendeve të Bashkimit Europian. Në Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA) dhe në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të vendeve të Europës Juglindore (ECSË Treaty), të nënshkruar dhe nga Qeveria Shqiptare në Tetor të vitit 2005, janë përcaktuar detyrime që duhet të plotësojë Qeveria Shqiptare, për të realizuar këtë bashkim. Një nga kushtet më të

rëndësishme të sektorit të energjisë elektrike, përcaktuar dhe në dokumentet e mësipërme, është krijimi dhe konsolidimi i tregut të energjisë elektrike të vendit tonë.

Duke marrë parasysh mangësitë e vërejtura deri tani, si dhe mungesën pothuajse totale të eksperiencës së vendit tonë, si në organizimin dhe operimin në tregje të tilla delikate, ashtu dhe në mbështetjen me kuadrin e nevojshëm ligjor, u vlerësua, që hapja e këtij tregu, të bëhej në mënyrë graduale. Kjo mënyrë operimi do të shoqërohej me ndryshime të rëndësishme, si në ligjin për sektorin e energjisë elektrike, ashtu edhe në modelin shqiptar të tregut të energjisë elektrike.

Ndryshimet e bëra në Ligjin Nr.9512 datë 10.04.2006 “Për sektorin e energjisë elektrike” ngarkuan Entin Rregullator të Energjisë (ERE), për përcaktimin e nivelit të konsumit për klientët e kualifikuar. Mbështetur në këtë detyrim, ERE vendosi, që të hiqen limitet e konsumit vjetor të energjisë elektrike, për të fituar statusin e klientit të kualifikuar, për të gjithë konsumatorët jo familjarë, pra, duke filluar nga data 1 Janar 2008, të gjithë konsumatorët jo-familjarë kanë të drejtën të përfitojnë statusin e Klientit të Kualifikuar.

Meqënëse, deri në vitin 2011 nuk kishim një hapje reale të tregut të energjisë elektrike, Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr.date 26.11.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar”, vendosi që:

“Klient i kualifikuar” do të konsiderohet automatikisht çdo konsumator i energjisë elektrike, i lidhur në rrjetin e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo konsumator tjetër i energjisë elektrike, që pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kWh.”

Ky ndryshim u bë dhe në përputhje të plotë me rregullat përkatëse të Bashkimit Europian, në pikën 20 të të cilit thuhet:

“20) Në mënyrë që të zhvillojnë konkurrencën në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, konsumatorët e mëdhenj jo-familjarë, duhet të jenë në gjendje të zgjedhin furnizuesit e tyre dhe të hyjnë në kontrata me furnizues të ndryshëm, për të siguruar kërkesat e tyre për energji elektrike.”

Në këtë mënyrë, duke filluar nga muaji Janar i vitit 2012, të gjithë konsumatorët, të përcaktuar si të kualifikuar nga ligji i sipërcituar, janë të detyruar të sigurojnë vetë energjinë elektrike, duke mos qënë ky një detyrim i KESH sh.a.-së. Në këtë mënyrë rritet numri i importuesve të energjisë elektrike, pra, do të kemi liberalizim dhe konkurrencë në rritje në këtë treg.

Synimi është, që deri në datën 1 Janar 2015, të kemi liberalizim të plotë të tregut, pra KESH-i nuk do të jetë i detyruar të sigurojë energji elektrike nga prodhues të tjerë.

Kjo lëvizje drejt liberalizimit të tregut, është në përputhje të plotë me detyrimin e përcaktuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, për hapjen e plotë të këtij tregu.

3.9.2 Tregu i naftës, gazit e produkteve të tyre

Tregu i naftës, gazit e produkteve të tyre është një treg i hapur dhe i liberalizuar, në të cilin shteti luan rolin e tij rregullator.

Për funksionimin e tregut të naftës dhe nënprodukteve të saj është përgatitur dhe është në zbatim legjislacioni dhe kuadri rregullator i nevojshëm, për kushtet dhe normat teknike, që duhet të zbatohen në ndërtimin dhe përdorimin e impianteve dhe instalimeve, që shërbejnë për depozitimin dhe tregtimin e produkteve hidrokarbure dhe gjithashtu, funksionon si një kuadër i plotë ligjor dhe rregullator, për standartet, që duhet të plotësojnë këto produkte, në respektim edhe të kërkesave të legjislacionit përkatës Europian.

Tregu i gazit rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr 9946, datë 30.06.2008, "Për sektorin e gazit", në zbatim të të cilit janë përgatitur dhe miratuar edhe aktet nënligjore përkatëse. Nga ana e ERE-s po plotësohen aktet e nevojshme, që rregullojnë procesin e licencimit dhe të rregullimit në tregun e gazit.

3.10 Privatizimi

Privatizimi konsiderohet si element kyç i reformës strukturore, që do të sigurojë një shërbim shumë më cilësor dhe sasior ndaj konsumatorëve, krahasuar me shërbimin e siguruar nga shoqëritë publike. Prandaj, e gjithë reforma e ndërmarrë në sektorin energjetik synon në komercializimin e shoqërive publike, që operojnë në këtë sektor dhe në zvogëlimin e rolit të shtetit në operimin e përditshëm të këtyre shoqërive, deri në privatizimin përfundimtar të tyre.

3.10.1 Privatizimi i sektorit të energjisë elektrike

Në Strategjinë e zhvillimit të sektorit elektrik është përcaktuar, që në këtë sektor, pas privatizimit të hidrocentraleve të vegjël, me fuqi deri në 2 MW, të vazhdojë privatizimi i sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe më pas, privatizimi i hidrocentraleve me fuqi të mesme.

Privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

Në zbatim të politikave të saj, paralelisht me veprimet për hapjen dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, në vitin 2009 Qeveria Shqiptare realizoi privatizimin e sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Modeli, që u zgjodh për privatizimin e OSSH, konsiston në shitjen e paketës kontrolluese të aksioneve të shoqërisë (76% të tyre) tek investitorët strategjik privatë, në përputhje me procedurat, që parashikohen në ligjin për prokurimet publike, në ligjin për privatizimin e sektorëve strategjik të ekonomisë, si dhe në Vendimet e Këshillit të Ministrave për këtë problem etj.

Me përfundimin e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) (Maj 2009), do të vazhdohet me privatizimin edhe të gjenerimit, pra do t'i hapet rruga hyrjes së burimeve të reja të kapitalit, eksperiencës dhe aftësive menaxheriale ndërkombëtare edhe në sektorin e gjenerimit, si dhe të teknologjisë moderne në këtë sektor.

Privatizimi i hidrocentraleve

Për privatizimin e hidrocentraleve do të kihet parasysh, që hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin, që përbëjnë dhe 95% të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike nga hidrocentralet, të mbeten në pronësi të shtetit.

Pra hidrocentrali i Vaut të Dejës me fuqi të instaluar 250 MW, hidrocentrali i Komanit me fuqi të instaluar 600 MW dhe hidrocentrali i Fierzës me fuqi të insrtaluar 500 MW, të mbeten pronë 100% shtetërore.

Sh.a. "Ulëz Shkopet," që ka në administrim HEC-et, aktualisht pronë publike, në Kaskadën e lumit Mat dhe konkretisht: Hidrocentralet e Ulzës dhe Shkopetit (gjithesj 49 MW), Sh.a. "Bistrica 1 Bistrica 2", që ka në administrim HEC-et, aktualisht pronë publike në Kaskadën e lumit Bistricër dhe konkretisht: Hidrocentralet e Bistrica 1 dhe Bistrica 2 (gjithësej 28MW), si dhe HEC Lanabregas, me fuqi të instaluar 5 MW do të privatizohen.

3.10.2. Privatizimi i sektorit të hidrokarbureve

Privatizimi i shoqërive publike të sektorit hidrokarbur përbën një hap të rëndësishëm për përmirësimin e performancës në këtë sektor.

Privatizimi i shoqërisë ARMO sh.a u krye brënda vitit 2008, me synim përmirësimin e ndjeshëm të sektorit të rafinimit dhe arritjen e standarteve ndërkombëtare në cilësinë e nënprodukteve të naftës.

Aktiviteti në sektorin e kërkimit të hidrokarbureve është kryesisht privat dhe realizohet nga kompani të huaja mbi bazën e marrëveshjeve hidrokarbure me shtetin Shqiptar.

Ndërsa procesi i privatizimit në sektorin e prodhimit i shoqërisë ALBPETROL sh.a., është mbështetur në ligjin nr. 10490, datë 15.12.2011, "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol", sh.a. Patos", si dhe në ndryshimet, që janë bërë në legjislacionin tjetër bazë, për aktivitetin e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve. (ligji nr. 31/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", të ndryshuar", si dhe ligji nr 32/2012, "Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)""

Privatizimi i shoqërisë Albpetrol sh.a. është parashikuar që të realizohet gjatë vitit 2012. .

4. FINANCIMET E PROJEKTEVE

Skenari RE&Ë ka përcaktuar nevojën dhe ritmikën e investimeve në sektorin energjetik, në sistemin e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, në sistemin elektroenergjetik, në zhvillimin e burimeve të rinovueshme dhe në efikasitetin e energjisë, për të realizuar zbatimin e tij. Nga krahasimi i investimeve, në sektorin energjetik rezulton, që investimet për Skenarin RE&Ë janë më të larta se skenari referues, për arsye të investimeve në efikasitetin e energjisë dhe në impiantet e shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme. Vlen të theksojmë, se pas kalimit të fazës së parë të investimeve, deri në vitin 2018, do të ndihet ndjeshëm efekti i tyre, që lidhet me uljen e konsumit të lëndëve energjetike, zhvillimin e energjive të pastra, si dhe uljen e emetimeve në atmosferë, të cilat janë më të vogla, krahasuar me skenarin referues .

Skenari i efikasitetit të energjisë promovon politika, për rritjen e efikasitetit të energjisë, të cilat tregojnë ndryshimet, krahasuar me skenarin referues.

- Skenari i efikasitetit të energjisë redukton me 1.3% ose (568 €Million) koston e sistemit energjetik,
- Skenari redukton me 8% importet ose në vlerë (4145 ktoes), referuar targetet e PKVË në rritjen e sigurisë së energjisë;
- Skenari redukton konsumin final të energjisë në 7.3% ose (5483 ktoes), si dhe redukton emimet e CO₂ me 7.2% (ose 11,781 Kt).

Skenari llogarit, që investimet afat-shkurtëra në total, për të gjithë sektorët e analizuar, në zbatimin e masave të efikasitetit, parashikohet të jetë në vlerën 6,687,000 Euro, deri në vitin 2018, të cilat do të shkojnë në vitin 2020 në 8.72 M Euro.

Kërkesa për investimet totale në sektorin e energjisë elektrike në periudhën 2009-2020 arrin në rreth 2471 Milion Euro, ku hidrocentralet e vogla kapin një vlerë investimi 785 milion Euro. Analizat e mësipërme janë bërë, duke u bazuar në burime të reja gjeneruese, që duhet të ndërtohen në Shqipëri me financime të investitorëve privatë. Në mbështetje të këtij koncepti, tashmë janë në fazë implementimi ose janë mbyllur procedurat e lidhjes së kontratave, për kaskadën mbi lumin Devoll, me kapacitet 270 MW, ndërtimin e HEC-it të Ashtës, me kapacitet 48 MW dhe është në fazën finale, për përcaktimin e fituesit të garës, për ndërtimin e HEC-it të Skavicës mbi lumin Drin, si dhe në kaskadën e lumit Vjosa.

Investimet në përmirësimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike janë përqëndruar në:

- Projektet e identifikuar të rrjetit të transmetimit 400 kV,
- Projektet e identifikuar më të rëndësishme të rrjetit të transmetimit 220 kV,
- Projektet e identifikuar më të rëndësishme të rrjetit të transmetimit 110 kV,
- Projekte të identifikuar për rehabilitimin e linjave dhe nënstacionet ekzistuese,

Bazuar në rezultatet e skenarit RE&Ë vërejmë se:

- Për të shtuar kapacitetet e reja prej 1328 MW, në vitin 2020 dhe 1596 MW në 2030, kërkohet një investim total prej 2471 M€, i cili përkthehet në një mesatare, 100M € në vit.
- Mbi 400M€ në vit do të duhen, për të mbuluar koston e paisjeve të reja të kërkuara në 2020.
- Pagesat vjetore, për lëndë djegëse primare, do të rriten në 1034M€/vit në 2020, dhe në vitin 2030 do të shkojnë sa dyfishi i vlerës aktuale të vitit 2006.
- Në Skenarin RE&Ë, emimet e CO₂ janë tre herë më të ulta se Skenari Referues.
- Konsumi për Frymë të CO₂ në skenarin RE&Ë është 0.55 tonCO₂/banorë nga 1.40tonCO₂/banorë të Skenarit Referues.
- Kursimi i energjisë në këtë skenar llogaritet 276 Ktoe krahasuar me skenarin Referues.

Analiza tregon se në periudhën e parë 2009-2020, investimet totale sipas Skenarit të Eficencës së Energjisë dhe të Burimeve të Rinovueshme janë më të larta se në Skenarin referues, për shkak të investimeve fillestare të larta, që në Skenarin e Eficencës së Energjisë dhe të Burimeve të Rinovueshme janë parashikuar për realizimin e veprave gjeneruese. Ndërsa për periudhat e tjera, kosto totale e investimeve në sistemin energjetik, sipas Skenarit të Eficencës së Energjisë dhe të Burimeve të Rinovueshme, është më e vogël, por përsëri me një diferencë të ndjeshme kundrejt Skenarit Referues. Nga krahasimi i skenareve referues me gaz dhe pa gaz si dhe skenareve të eficientës së energjisë dhe skenareve të EE & RES me gaz dhe pa gaz, vërejmë këto diferenca kumulative:

- Skenari referues me gaz është më i lirë se skenari pa gaz, me një vlerë kumulative 595.72 Meuro,
- Skenari Eficencë Energjie me gaz është më i lirë se Skenari me Eficencë pa gaz, me një vlerë kumulative 649.86 Meuro
- Skenari E&RE me gaz është më i lirë se Skenari EE&RE me gaz, me një vlerë kumulative 136.69 Meuro




Figura 13 Kostua totale e sistemit energjetik sipas skenareve

Investimet në sektorin hidrokarbur

Sipas vlerësimeve, investimet në sektorin hidrokarbur, parashikohen të jenë rreth 430 Milion Euro deri në vitin 2020 e ndarë në kërkime 109 Milion Euro, në rafineri 43 Milion Euro, në terminale 68 Milion Euro dhe në lidhjen e Shqipërisë me rrjetin e gazit natyror 250 Milion Euro. Vlen të përmendim koston e investimeve në këtë sektor përballohet tërësisht nga investitorët privat.

Investimet e parashikuara për energjitë e rinovueshme

Këto investime do të fokusohen në shfrytëzimin e energjisë hidrike, në energjinë e erës, diellit dhe biomasës, për të cilat parashikohen të zhvillohen në mbështetje të realizimit të objektivave, që ka vendi ynë në Komunitetin e Energjisë. Vlen të përmendim, se koordinimi i investimeve për zhvillimin e energjive të pastra, do të lidhet ngushtë me incentivat, që do të merren nga Qeveria e Shqipërisë.

Tabela 4. Investimet e parashikuara për energjitë e rinovueshme

Vitet	2012	2013	2015	2017	2019	2020
Energjia diellore [ktoe]	29,8	39,8	49,8	59,9	69,9	79,9
Investimi [Milion EURO]	29	38,5	48	57,5	67	75,5
Energjia e prodhuar nga era [ktoe]	9,1	13,6	18,1	22,6	27,1	31,6
Investimi [Milion EURO]	35,5	54	61,5	70	79,5	88

Energjia e prodhuar nga HEC-et e vegjël [ktoe]	25,7	33,7	41,7	49,7	57,7	65,7
Investimi [Milion EURO]	44.9	48.5	62	75.5	88	100.5
Energjia e prodhuar nga Impiantet me Koogjenerim [ktoe]	21,72	29,71	37,71	45,71	53,71	61,71
Investimi [Milion EURO]	29.77	44.17	55.77	64.17	73.77	82.17

Burimi AKBN

Investimet në përmirësimin e efikasitetit të energjisë

Investimet për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin energjetik konsistojnë të ndara sipas sektorëve si më poshtë:

- Paketa e masave në sektorin e banesave llogarit kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2018, 37 (ktoe) dhe në vitin 2020, 48.2 ktoe,
- Paketa e masave në sektorin e shërbimeve, llogarit kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2018, 32 (ktoe) dhe në vitin 2020, 41.7 ktoe
- Paketa e masave në industri, kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2018, janë 42 (ktoe) dhe në vitin 2020, 54.7 ktoe
- Paketa e masave në sektorin e transportit, kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2018 janë 52 (ktoe) dhe në vitin 2020, 67.7 ktoe
- Paketa e masave në bujqësi, kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2018 janë 5 (ktoe) dhe në vitin 2020, 6.5 ktoe.
- Skenari llogarit, që investimet afat-shkurtëra në total, për të gjithë sektorët e analizuar, në zbatimin e masave të efikasitetit, parashikohet të jenë në vlerën 6,687,000 Euro deri në vitin 2018, të cilat do të shkojnë në vitin 2020 në 8.72 M Euro.

Investimeve sipas sektorëve

Investimet sipas sektorëve të paraqitur në figuren 14 tregojnë, se sektori i transportit ka shpenzime të larta, të cilat në krahasim me sektorët e tjerë, ai dominon më shpenzime 64.7%, më pas vijnë investimet në impjante, të cilat do të shkojnë 13 %, sektori i banesave do të ketë investim 11,9% dhe investimet në teknologji 4,8 %.




Figura 14 Ecuria e shpenzimeve sipas sektorëve (Meuro)

Raporti i investimeve

Një tregues i rëndësishëm në ecurinë e investimeve në sektorin energjetik është pesha që do të mbajnë investimet nga burimet e ndryshme financimi, të tilla si: donatorët, investimeve nga sektori privat,

investim i kompanive publike dhe buxheti i shtetit për sistemin elektroenergjetik dhe hidrokarbur, duke përfshirë eficientë dhe burimet e rinovueshme.

Në Tabelën 5, vërehet, që sektori privat duhet të ketë kontributin kryesor në investime, për të arritur objektivat kryesore të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, prandaj ndërtimi i politikave lehtësuese në thithjen e investimeve nga ky sektor, duhet të jetë një nga detyrat parësore të Qeverisë Shqiptare.

Tabela 5: Raporti i investimeve

Spektori Elektrik	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Total
Investim privat	53%	47%	92%	92%	93%	94%	95%	96%	96%	97%
Donatorët	42%	78%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Investim i publik	5%	8%	8.10%	7.60%	6.80%	6.20%	5.10%	4.40%	3.60%	3.30%
Spektori Hidrokarbur	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Total
Investim privat	95%	94%	94%	93%	93%	95%	96%	97%	96%	94%
Investimi i kompanisë	5%	6%	6%	7%	7%	5%	4%	3%	4%	6%
Inves. Eficientë dhe Burim. Rinovueshme	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Total
Investim Privat	87%	86%	90%	90%	90%	88%	87%	86%	85%	83%
Donatorët	9%	6%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Qeveria	4%	8%	10%	10%	10%	12%	13%	14%	15%	17%

5. LLOGARIDHËNIA

Qeveria është e angazhuar për të rritur transparencën në të gjithë procesin e hartimit të strategjive dhe të politikave të zhvillimit të sektorit energjetik. Pjesëmarrja në formulimin e planeve strategjike ka bërë të mundur, që aktorët e interesuar të marrin më shumë informacion gjatë zgjedhjeve të politikave të kësaj Strategjie.

Ky kapitull trajton procesin e gjerë të pjesëmarrjes së institucioneve dhe specialistëve të ndryshëm gjatë përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe përshkruan se si do të monitorohet progresi për zbatimin e saj.

5.1. -Procedurat për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë

Strategjia Kombëtare e Energjisë, e Përditësuar, filloi hartimin bazuar në:

Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr.267, datë 26.03.2012, "Për ngritjen e grupit të punës dhe këshillimor, për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, për periudhën 2013-2020".

Hapat e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2013-2020, përfshijnë:

- 1 Organizimi i grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2013-2020,
- 2 Sigurimi i të dhënave bazë të energjisë;
- 3 Konsultimi me institucione të sektorit të energjisë dhe institucione të tjera për prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë,
- 4 Konsultimi me grupin këshillimor për draftin e Strategjisë;
- 5 Dërgimi i draftit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2013-2020 në Ministrinë e linjës për mendime;
- 6 Konsulenca e huaj dhe diskutim me donatorë **dhe faktorë të interesit**,
- 7 Dërgimi i draftit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2013-2020 në Këshillin e Ministrave, për shqyrtim dhe miratim.

5.2. -Monitorimi

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Ai mbështetet mbi një listë indikatorësh të përzgjedhur për sektorët, ku do të përcaktohen planet zbatuese, që parashikojnë të sjellin përmirësimin e parametrave të sektorit energjetik. Për këtë janë përfshirë edhe fondet përkatëse në kuadër të programit "Mbështetje për Energjinë", në PBA, për periudhën 2013 – 2015. Këta indikatorë janë përcaktuar për arritjen e qëllimeve strategjike dhe janë hartuar në funksion të nivelit të ndikimit dhe të rezultateve.

Nisur nga problematika e sektorit të energjisë dhe nga detyrat e strategjisë së energjisë është përgatitur një plan afatshkurtër i masave për vitet 2013-2015, zbatimin e të cilit do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e situatës në sektorin energjetik, si dhe një program me detyra afatgjata, për stabilizimin e plotë të situatës në sektorin energjetik shqiptar.

6. PLANI AFATSHKURTËR I MASAVE PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERGJISË, TË PËRDITËSUAR, PËR PERIUdhËN 2012-2015

Objektivat për periudhën 2013 - 2015

Për realizimin e objektivave është parashikuar një paketë masash, ku përfshihen përmirësimi i performancës së sektorit elektrik publik, ndërhyrja në kuadrin ligjor, organizativ, fuqizimi i sektorit elektroenergjetik Shqiptar dhe përmirësimi i performancës së sektorit të hidrokarbureve.

I. Masat për përmirësimin e performancës së sektorit elektrik publik

Masat Organizative

- Do të vazhdojë puna për ristrukturimin e shoqërisë KESH sh.a, OST sh.a dhe OSSH sh.a, për ndarjen e verpimtarive të tyre në veprimtari më specifike, të percaktuara në këtë strategji.
- Do të vazhdojë puna, për organizmin e AKBN-së, në mënyrë, që të realizojë detyrën e vet, në monitorimin dhe realizimin e bilanceve energjetike;
- Do të vazhdojë puna, për organizmin e AKBN-së, në mënyrë, që të realizojë detyrën e vet, në monitorimin e marrëveshjeve të ndryshme koncesionare;
- Do të vazhdojë puna, për organizmin e AKBN-së, në mënyrë, që të realizojë detyrën e vet, në monitorimin e zbatimit të detyrave, për rritjen e efikasitetit të energjisë, sipas PKVË;
- Do të vazhdojë puna, për organizmin e AKBN-së, në mënyrë, që të realizojë detyrën e vet, në monitorimin e detyrave, për burimet e rinovueshme, sipas PKVBR

Masat Teknike

- Do të realizohen të gjitha masat teknike, për pranimin e OST sh.a. në ENTSO;
- Do të fillojë projekti, për rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve të sistemit elektroenergjetik; (KESH)
- Do të përfundojë ndërtimi i objekteve të prodhimit të energjisë elektrike, sipas marrëveshjeve koncesionare;
- Do të ndërtohet linja e interkoneksionit 400 kV Tiranë – Prishtinë;
- Do të përfundojë ndërtimi i Qendrës së Re Kombëtare Dispeçer
- Do të përfundojë rehabilitimi i të gjithë nënstacioneve 400 dhe 220 kV
- Do të kryhet në mënyrë të rregullt nga KESH-i pagesa e energjisë së prodhuar nga HEC-et e vegjël dhe e blerë nga ai.

Masat e Qeverisë

- Do të realizohet pagesa në masën 100% e faturave aktuale për konsumatorët buxhetorë dhe jo-buxhetorë;
- Do të kryhet financimi për pagesat e detyrimeve të prapambetura për konsumatorët buxhetorë dhe jo-buxhetorë;
- Do të zbatohet skema për mbrojtjen e konsumatorëve familjarë me të ardhura të ulta nga rritjet e planifikuara të tarifës së energjisë elektrike;
- Do të mbështetet pjesëmarrja e investitorëve privat, për investime në sektorin e gjenerimit;

- Do të bëhet zgjidhja e problemit të detyrimeve të prapambetura dhe nuk do të lejohet më krijimi i tyre, nëpërmjet pagesave në kohë, të detyrimeve të subjekteve buxhetore dhe jobuxhetore;
- Do të synohet eliminimi i ndërsuvencioneve tarifore për të gjithë konsumatorët buxhetorë, jo-buxhetorë dhe privat dhe përcaktimi i tyre, sipas kostove, për nivelet respektive të tensionit;

II. Masat për zhvillimin e mëtejshëm në sektorin e energjisë elektrike 2013-2020

- Masat për plotësimin e kuadrit ligjor e nënligjor të sektorit;
- Përafrimi i kuadrit ligjor të sektorit me atë të vendeve të Bashkimit Europian, nëpërmjet adaptimit të “Acquive Communitare”. Për këtë qëllim:
- Do të hartohen dhe miratohen aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për energjitë e rinovueshme”, brënda vitit 2013.
- Do të hartohen dhe miratohen aktet nënligjore në zbatim të ligjit “Për eficientë e energjisë”, brënda vitit 2013.

Masat për fuqizimin e Sistemit Elektroenergjetik

Do të zbatohen në kohë projektet e ndryshme, që synojnë përmirësimin e infrastrukturës për prodhimin e energjisë, transmetimin dhe shpërndarjen e saj dhe integrimin në rrjetin rajonal elektroenergjetik, si dhe diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike

Për të realizuar këto objektiva:

- Do të përfundojë ndërtimi i hidrocentraleve të lumit Devoll;
- Do të përfundojë ndërtimi i linjës 400 kV Tiranë – Prishtinë;
- Do të përfundojë ndërtimi i Qendrës së Re Kombëtare Dispeçer;
- Do të ndiqen procedurat, për zbatimin e Master Planit, për ndërtimin e linjave dhe nënstacioneve të tensionit 110 kV e lartë.
- Do të realizohet projekti, për rritjen e sigurisë së digave të HEC-eve;
- Do të vazhdojë ndjekja e procedurave, për ndërtimin me konçesion të hidrocentralit të Skavicës, mbi lumin Drin;
- Do të ndiqen procedurat, për ndërtimin me konçesion, të HEC-eve të rinj mbi lumin Vjosë.
- Do të ndiqen procedurat, për ndërtimin me konçesion, të HEC-eve të rinj mbi lumin Osum;
- Do të vazhdojë dhënia me konçesion e hidrocentraleve të vegjël në lumenjtë e tjerë të vëndit.
- Do të fuqizohet procesi i monitorimit të projekteve koncesionare gjatë zbatimit të tyre.

Masa të tjera

Do të vazhdojë puna, në zbatim të angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare, në fushën e energjisë, me objektiv ngritjen e një tregu konkurrues rajonal të energjisë elektrike.

III. Sektori Energjetik Hidrokarbur

Për realizimin e objektivave afat-shkurtër është parashikuar një paketë masash në sektorin hidrokarbur, ku përfshihen: ndërhyrja në kuadrin ligjor, në aspektet e kuadrit organizativ dhe në fuqizimin e sistemit të furnizimit me lëndë hidrokarbure të tregut Shqiptar.

Masat për diversifikimin e burimeve të furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte, si dhe lidhjen e Shqipërisë me rrjetin rajonal të naftës-jellësve dhe gazsjellësve.

- Ndjekja e praktikave ligjore dhe administrative për linjat e interkoneksionit me rrjetin rajonal të gazsjellësit (Projekti TAP dhe Projekti IAP), 2013-2015
- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe vëndet e rajonit për praktikat dhe procedurat e realizimit të projekteve në lidhje me Energy Community Gas Ring. 2013-2015

Për rritjen e investimeve në kërkim dhe prodhim të burimeve energjetike hidrokarbure, si dhe për rritjen e sigurisë së furnizimit të tregut me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre

- Rishikimi i praktikave ligjore, procedurave administrative dhe teknike për mbajtjen dhe menaxhimin e Rezervës së Sigurisë së Produkteve të Naftës. (2012 – 2013).
- Nxitja e investimeve të huaja për zbulimin e vendburimeve të reja, ndjekja e marrëveshjeve hidrokarbure me kompaninë Capricorn Albania Ltd. për bllokun detar Joni 5 në det dhe me kompaninë San Leone Energy Plc. për bllokun “Durrësi” në det, si dhe për marrëveshjet me kompaninë Petromanas Albania GmbH, për Blloqet e kërkimit A-B dhe D-E, si dhe 2-3 në tokë. (2012 – 2015).....
- Ndjekja e realizimit të investimeve të huaja, në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure, për zhvillimin e vendburimeve ekzistuese me kompaninë e Bankers Petroleum Albania Ltd (Vendburimi Patos Marinëz), me kompaninë Share-Wood International Ltd. (Vendburimi i Kuçovës), me kompaninë Stream Oil and Gas (për vendburimet gëlqeror Cakran – Mollaj, Ballsh – Hekal, Gorisht – Kocul dhe bllokun e kërkimit Delvinë), si dhe me kompaninë IEC Viskoa Inc. (për vendburimin Visokë) . (2012 – 2015)
- Përmirësimi dhe zhvillimi i penetrimit të GLN si lëndë djegëse në banesa, shërbime publike dhe private nga 25-30 kg/banorë në 35- 40 kg/banorë. (2012 – 2015)
- Zbatimi i standarteve të cilësisë së produkteve të naftës dhe gazit sipas ligjislacionit ekzistues. (2009-2011).
- Realizimi i projekteve dhe studimeve për kërkimin, zbulimin dhe zhvillimin e burimeve energjetike me bazë hidrokarbure, si dhe për shfrytëzimin racional të tyre. (2012 – 2015)
- Realizimi i projekteve dhe studimeve për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e situatës mjedisore në aktivitetet e sektorit energjetik hidrokarbur, në kuadër të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të industrisë që lidhet me to. (2012 – 2015)
- Vlerësimi i kapaciteteve naftë-gazmbajtëse, në kushtet e zbatimit të teknologjive të reja të nxjerrjes, duke rivlerësuar gjithashtu edhe rezervat sipas standarteve të BE. (2012 – 2015)

Masat për përmirësimin e kuadrit ligjor në sektorin energjetik hidrokarbur

- Kuadri ligjor plotësues dhe aktet nënligjore si dhe rregullat teknike për gazin natyror, i cili do të përfshijë edhe kuadrin rregullator teknik, për ndërtimin dhe përdorimin e rrjetit të gazsjellësve, si dhe ngritjen e instalimeve të gazit në ndërtesa dhe në industri, të cilat janë thelbësore, për rritjen e kërkesës për gaz dhe krijimin e tregut respektiv. (2012 – 2015)
- Ngritja e strukturave për sektorin e gazit natyror në përbërje të Entit Rregullator të Energjisë, si dhe përgatitja e gjithë praktikave dhe procedurave institucionale dhe administrative, për funksionimin ligjor të këtyre strukturave. (2012 – 2015)
- Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport”, si dhe përcaktimi i strukturave institucionale dhe administrative për implementimin e dispozitave të këtij ligji. (2012 – 2015)
- Miratimi i “Rregullores për aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri” (2012-2015)
- Përmirësimi i kuadrit ligjor, për praktikat dhe procedurat e dhënies së lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve, për tregtimin me shumicë dhe/ose pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të

tyre, veçanërisht, përsa i përket kushteve të licensimit (kapaciteteve depozituese), si dhe shpërndarjes gjeografike të stacioneve të shitjes së karburanteve në rrugët nacionale. (2012 – 2015)

IV. Masat për rritjen e Efiçencës

- Monotorimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Efiçencës së Energjisë (PKVEE), aprovuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 619 datë 7.9.2011 (2012-2015)
- Miratimi i **kuadrit ligjor mbi “Efiçencën e Energjisë” 2012**
- **Përgatitja e plotë e kuadrit ligjor sekondar në zbatim të ligjit për efiçencën e energjisë, 2012-2015**
- Implementimi i kërkesave minimale të efiçencës së energjisë në ndërtesa me shumë banesa, 2012-2015,
- Implementimi i standarteve minimale për paisjet elektro-shtëpiake efiçente, 2012-2015

- Instalimi i llampave efiçente në ndërtesat publike dhe private të shërbimeve. (2012-2015).
- Përgatitja e Çertifikimi i banesave të reja në përputhje me direktivën e BE për banesat, (2012-2015).
- Përgatitja e Standarteve të efiçencës së energjisë për ndërtesat e reja publike (2012-2015)
- Përgatitja e Skemave të auditimit për industrinë, (2012-2015)
- Përgatitja, Etiketimi energjetik i automjeteve të reja (2012-2015)
- Realizimi i Programit për Promovimin e Burimeve të Rinovueshme dhe Efiçencës së Energjisë të financuar nga KfW, (2012-2015)
- Fushata sensibilizimi:
 - Ndërgjegjësimi i popullatës dhe konsumatorëve të sektorit të shërbimeve, nëpërmjet programeve në media, mbi efektet pozitive të termoizolimit në drejtim të kursimit të energjisë, llampat dhe pajisjet elektroshtëpiake efiçente;
 - Orientimi i familjeve ndaj përdorimit të drejtë të LNG-së.

V. Aplikim i skemave të Energjive të Rinovueshme

Përdorimi i energjive të rinovueshme është një prioritet tjetër i Qeverisë dhe reflektohet edhe në këtë strategji. Më poshtë jepen disa nga projektet që duhen zbatuar në këtë fushë:

- Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme 2012
- Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme (2012-2015)
- Miratimi i ligjit të ri për Burimet e Rinovueshme, 2012
- Përgatitja e kuadrit sekondar, për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme, 2012-2013
- Studimi në bashkëpunim me KfW, për përgatitjen e Atlasit të Energjisë së Erës (2012-2015);
- Studimi dhe investimi për ndërtimin e paneleve diellore (PNUD). (2012-2015);
- Njërtimi i skemave, për Penetrimin në një shkallë më të gjërë i paneleve diellore, për sigurimin e ujit të ngrohtë në sektorin e popullatës dhe të shërbimeve; 2012-2015
- Ndërtimi i skemave, për shfrytëzimin e energjisë nga biomasa, në zonat rurale dhe në zonat urbane. (2012-2015).

7. LITERATURA

1. “Strategjia Kombëtare e Energjisë për periudhën deri në vitin 2015”. (AKE, 2003)

2. "Plani i Masave për Implementimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën deri në vitin 2015". (AKE, 2003-2004)
3. "Strategjia e zhvillimit të Sektorit Hidrokarbur për periudhën 2005-2015". Q.K.SH.H., Fier 2005
4. Raporte Vjetore të ERE, 2009, 2010, 2011
5. Pyetësori për BE- Kapitulli 15 "ENERGJIA", Tiranë 2010.
6. Pyetësori për BE- Kapitulli 21 "Rrjetet Trans Europiane të Transportit", Tiranë 2010.
7. Studimi "Zhvillimi i integruar (në sinergji) i Zonës Energjetike dhe Industriale të Porto Romano, Durrës dhe infrastruktura e saj" (Miratuar me VKM nr. 703, datë 23.04.2008 "Për miratimin e studimit 'Zhvillimi i integruar (në sinergji) i Zonës Energjetike dhe Industriale të Porto – Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj"., Tiranë 2008.
8. Studimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për gazifikimin e Europës Jug-Lindore ,
9. Analiza e Vlerësimit të Rafinerive tona.
10. Energy Price and Taxes (2010, 2011).
11. Energy Price and Taxes International Energy Agency.
12. Energy Sector Development Strategy of the Republic of Croatia.
13. Full environmental benchmark survey for the rehabilitation of Patos-Marinez oilfield, Albania.
14. Industria e naftës dhe e Gazit në Shqipëri, 2002, 2003, 2004, Buletin Informativ, Shkencor dhe Statistikor. Fondi i QKSHH Fier
15. Key World Energy Statistics 2010, 2011.
16. Kuadri ligjor për sektorin e Energjisë në Shqipëri.
17. Oil, Gas, Coal and Electricity Statistic of International Agency of Energy 2006
18. Optimizimi i Tregut të Produk. të Naftës&Gazit. DPH, QKSHH AKE Fier 2004
19. Përcaktimi i Hapësirave të Përshtatshme për Ndërtimin e Depozitave Bregdetare të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre. Tiranë, Janar 2001, Fondi i QKSHH Fier
20. Përcaktimi i Hapësirave të Përshtatshme për Ndërtimin e terminaleve bregdetare të GNL, në bregdetin e Qarkut Fier, Tiranë, 2007, Fondi i METE
21. Politika Energjetike Shqiptare, për një Zhvillim të Qëndrueshëm. (AKE, Tirane 2004)
22. Pollution and environment management. J.M.Hellawell, Pollution monitoring series
23. Raporti Shkencor i Projektit: Studimi për optimizimin e tregut të nënprodukteve të naftës dhe gazit në Shqipëri. (Fondi QKSHH, Fier)
24. Strategjia e tranzicionit të gazit, European Energy Community 2005.
25. Studim për interkoneksionin me rrjetin e gazit. (Fondi AKE Tirane, 1993, 1997, 2000, 2003, 2004,2005,2006).
26. Studim për sektorin shqiptar të energjisë Banka Botërore 2003.
27. Studimi Power Sector Rehabilitation and Restructuring Project, Lahmeyer International GmbH
28. Studimi i Parkut Industrial, Vlorë. (Fondi AKE Tiranë, 2004).
29. World Energy Outlook -2009, 2010 IEA, International Energy Agency, Paris 2010, 2011.
30. Buletin Mensuel 2004-2005 Committè Professionel Du Pètrole